



RAPORT AKADEMIK

2022-2023

PËRMBAJTJA

Hyrje

- KREU I VEPRIMTARIA AKADEMIKE E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS
- I. I PROGRAMI I FORMIMIT FILLESTAR
 - I. I. a Provimi i pranimit
 - I. I. b Viti i parë
 - I. I. c Viti i dytë
 - I. I. d Provimi përfundimtar pas vitit të dytë
 - I. I. e Viti i tretë
 - I. I. f Përbushja e objektivave mësimore
 - I. I. g Stafi pedagogjik
 - I. I. i Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë
- I. II PROGRAMI I FORMIMIT VAZHDUES
 - I. II. a Analiza e nevojave për trajnim dhe miratimi i kalendarit të aktiviteteve trajnuese
 - I. II. b Metodologjia e aktiviteteve trajnuese
 - I. II. c Realizimi i kalendarit të trajnimeve
 - I. II. d Ekspertiza
 - I. II. e Pjesëmarrja e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të së Drejtës
 - I. II. f Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe institucione të tjera të drejtësisë në vend
- I. III BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT KOMBËTARË E NDËRKOMBËTARË
 - I. III. a Drejtimet e bashkëpunimit
 - I. III. b Aktivitete të rëndësishme gjatë vitit akademik 2022-2023
- I. IV PUBLIKIMET DHE PUNA KËRKIMORE SHKENCORE
 - I. IV. a Raportim mbi ecurinë e Publikimeve dhe kërkimit shkencor për vitin akademik 2022 - 2023
 - I. IV. b Botimi i Revistës Shkencore “Jeta Juridike”
 - I. IV. c Botimi i Revistës “Magjistrati”
 - I. IV. d Botime tekstesh dhe librash

- I. IV. e Kriteret e zbatuara për botimet e Shkollës, të revistës “Jeta Juridike” dhe të teksteve
- I. IV. f Miratimi i botimeve shkencore nga Bordi i Redaktorëve
- I. IV. g Puna kërkimore shkencore 2022-2023

- I. IV. h Objektivat e publikimeve dhe punës kërkimore shkencore 2023-2024
- I. IV. i Biblioteka
- I. V ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
- I. V. a Platforma SMVSHM
- I. V. b Forumi i Shkollës së Magjistraturës
- I. V. c Biblioteka Digjitale
- I. V. d Digjitalizimi i mësimdhënies
- KREU II PRIORITETET E SHKOLLËS PËR VITIN E RI AKADEMIK 2022-2023
- II. I. a Për Programin e Formimit Fillestar
- II. I. b Për Programin e Formimit Vazhdues
- II. I. c Për projektet dhe marrëdhëniet me jashtë
- II. I. d Publikimet dhe puna kërkimore shkencore 2022-2023
- II. I. e Për avancimin e teknologjisë së informacionit

SHKURTIME

Shkolla e Magjistraturës	SHM
Këshilli i Lartë Gjyqësor	KLJG
Këshilli i Lartë i Prokurorisë	KLP
Prokuroria e Përgjithshme	PP
Ministria e Drejtësisë	MD
Avokati i Përgjithshëm i Shtetit	APSH
Inspektori i Lartë i Drejtësisë	ILD
Gjykata e Lartë	GJL

HYRJE

Shkolla e Magjistraturës, gjatë vitit akademik 2022-2023, ka realizuar me sukses programin mësimor për Formimin Fillestar për tre vite mësimore, duke përgatitur 196 kandidatë, nga të cilët 117 kandidatë për gjyqtarë, 75 kandidatë për prokurorë, 1 kandidat për këshilltar dhe 3 ndihmës ligjorë, që do t'i bashkohen sistemit gjyqësor në vitet në vijim. Në vitin 2023 u diplomuan 40 gjyqtarë dhe 26 prokurorë.

Pas procesit të rekrutimit të organizuar në prill 2023, në Shkollë nisen Programin e Formimit Fillestar 74 kandidatë për gjyqtarë, prokurorë e ndihmës ligjorë.

Në Programin e Formimit Vazhdues gjatë vitit akademik 2022 -2023, Shkolla ka trajnuar 202 gjyqtarë, 145 prokurorë, 107 Oficerë të Policisë Gjyqësore dhe 14 kancelarë, bazuar në kërkesën e tyre për trajnim dhe vlerësimin e Shkollës së Magjistraturës përmes një procesi metodologjik bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të shkollave homologe. Në këto aktivitete një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe bashkëpunimi me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë, të cilët kanë mbështetur ekspertizën e Shkollës dhe kanë bashkëpunuar në organizim apo logjistikë.

Një hapësirë të rëndësishme përgjatë vitit akademik 2022-2023, Shkolla i ka kushtuar analizës së punës së saj dhe mundësisë për përmirësime, si në Programin e Formimit Fillestar, në Programin e Formimit Vazhdues dhe në Departamentin e Studimeve dhe Publikimeve. Kjo analizë është shoqëruar me konsultime me pedagogët e Shkollës, me diskutime të gjera në Këshillin Pedagogjik dhe Këshillin Drejtues të Shkollës. Si rrjedhojë ka pasur reflektime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës dhe përmirësime të metodologjisë dhe kurikulave.

Gjithashtu, nisja e procesit për hartimin e Strategjisë së Shkollës për vitet 2024-2028 krijoi mundësinë për të parë të ridimensionuar Shkollën në vitet që do të vijnë dhe për të nisur qysh këtë vit nga procese të rëndësishme përmirësuese të aktivitetit të Shkollës.

Ky raport synon të japë një informacion të detajuar, të qartë e të kuptueshëm për çdo subjekt që është i interesuar të njohë e analizojë aktivitetin e saj. Informacioni është i shoqëruar me të dhëna statistikore dhe pasqyrojnë ecurinë e veprimtarisë akademike të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023.

KREU I VEPRIMTARIA AKADEMIKE E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

KREU I VEPRIMTARIA AKADEMIKE E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS


II PROGRAMI I FORMIMIT FILLESTAR

Gjatë vitit akademik 2022-2023, Shkolla e Magjistraturës realizoi Programin e Formimit Fillestar për tre vite studimi, për 194 kandidatë për magjistratë, 1 kandidat për këshilltar ligjor dhe 3 kandidatë për ndihmës ligjorë. Shkolla realizoi edhe programin e trajnimit 9-mujor për tre subjekte të rivlerësimit, për dy prokurorë dhe një ndihmëse ligjore.

Përgjatë këtij viti akademik i është kushtuar një vëmendje e posaçme analizës së provimit të pranimit, metodologjisë së realizimit të programit të formimit fillestar, ngarkesës studimore dhe mënyrave të vlerësimit të kandidatëve.

Kjo analizë iu nënshtrua një procesi të gjatë vlerësimi në Këshillin Pedagogjik dhe Këshillin Drejtues dhe po vijon puna për krijimin e mundësive për implementimin e rezultateve të saj.

Ky vit dëshmoi sërish një përpjekje të jashtëzakonshme për të rritur cilësinë e drejtësisë së ardhshme dhe për të qenë sa më pranë nevojave të profesionit të nderuar të magjistratit.



Kandidatë për magjistratë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë për vitin akademik 2022-2023

I. I. a Provimi i pranimit

Pas shpalljes së 45 vendeve vakante nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor për profilin gjyqtar dhe 15 vendeve vakante për profilin ndihmës ligjorë dhe pas shpalljes së 35 vendeve vakante për profilin prokurorë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës nisi procedurat për zhvillimin e provimit të pranimit për vitin akademik 2022-2023.

1) Njoftimi publik

Në datën 1 shkurt 2022 Shkolla e Magjistraturës publikoi në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës, www.magjistratura.edu.al. njoftimin për zhvillimin e provimit të pranimit, si dhe bëri publik:

- Numrin e vendeve vakante për të tre kategoritë;
- Kriteret e pranimit për të tre kategoritë;
- Periudhën gjatë së cilës mund të paraqiteshin kërkesat për aplikim;
- Datat e zhvillimit të provimit të pranimit;
- Programin e provimit të pranimit, ku përfshiheshin temat dhe literatura përkatëse.

2) Vlerësimi paraprak i konkurrentëve kandidatëve aplikues

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 52, datë 8.4.2022, “Për procesin e zhvillimit të provimit të pranimit për vitin akademik 2022-2023”, u ngrit komisioni për vlerësimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga konkurrentët, i cili pasi procedoi me verifikimin paraprak të tyre, përcolli pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, raportin mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të konkurrentëve për pranimin në Formimin Fillestar për vitin akademik 2022-2023, duke dhënë informacion mbi kandidatët, të cilët plotësonin kriteret e pranimit, si dhe konkurrentët të cilët nuk i plotësonin kriteret e pranimit, bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 96/2016 dhe të nenit 10 të Rregullores së Brendshme të Shkollës.

Në vijim të procedurës së parashikuar në ligjin nr. 96/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcolli pranë Shkollës së Magjistraturës opinionet dhe komentet mbi vlerësimin paraprak të dokumentacionit.

3) Raporti i vlerësimit përfundimtar

Shkolla e Magjistraturës, duke pasur në vëmendje opinionet dhe komentet e bëra, shpalli në faqen zyrtare të saj raportin mbi vlerësimin përfundimtar të konkurrentëve që do të merrnin pjesë në provimin e pranimit për vitin akademik 2022 – 2023.

4) Trajnimi i konkurrentëve për rregullat e testimit me scan tron dhe profesional

Shkolla e Magjistraturës zhvilloi pranë mjediseve të saj procesin e trajnimit të konkurrentëve në lidhje me rregullat e testimit në përgjithësi dhe në veçanti të fazës së parë, për mënyrën e plotësimit të fletës scan tron, si dhe të vlerësimit, i cili bëhet në formë elektronike me anë të pajisjes scantron. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe shpjegimit të metodologjisë së zhvillimit të fazës së dytë të provimit (Testit Profesional), duke pasur

parasysh formën e tezës së provimit, tipologjinë e pyetjeve, mënyrën e zhvillimit të saj sa i përket menaxhimit të kohës etj.

5) Zhvillimi i provimit

Provimi i pranimit u zhvillua në datat:

- 22 prill 2022 – faza e parë e testit të vlerësimit elektronik;
- 25 prill 2022 – faza e dytë, testi profesional.

Duhet vënë në dukje se Shkolla i kushtoi një vëmendje të veçantë rishikimit të tezave të provimit për çdo fushë që përmban provimi hyrës në testimin e fazës së parë, në funksion të harmonizimit të tij me kërkesat profesionale që kërkohen për konkurrentët në këtë fazë.

Faza e parë e testimit - testi i vlerësimit elektronik

Në datën 22.4.2022 u zhvillua faza e parë e provimit të pranimit, në mjediset e Pallatit të Kongreseve.

Modeli i tezës së provimit, i miratuar nga Këshilli Drejtues, në fazën e parë ishte i strukturuar në formë pyetjesh me alternativa, nëpërmjet të cilave testohen njohuri të karakterit profesional, por edhe intelektual e gjuhësor. Përgjigjet u dhanë në mënyrë skematike, pa fjalë, sipas teknikës scan tron.

Teza përmbante 100 pyetje të strukturuar në 9 rubrika, 8 nga të cilat me nga 10 pyetje/1 pikë secila dhe gjuha shqipe me 20 pyetje/1 pikë secila. Rubrikat e tezës ishin: 1) Test inteligjence (logjikë, gjeografi etj.); 2) Marrëdhënie ndërkombëtare – BE – Histori - E drejtë e krahasuar; 3) Gjuhë shqipe; 4) Psikologji – Komunikim; 5) Etikë e sjellje qytetare; 6) E drejtë kushtetuese - Të Drejtat e Njeriut – E drejtë administrative; 7) E drejtë familjare – E drejtë pune – E drejtë tregtare; 8) E drejtë civile – Procedurë civile; 9) E drejtë penale – Procedurë penale.

Tezat e çdo rubrike ishin vendosur në zarfe (9 zarfe gjithsej). Teza e rënë në këtë fazë u përzgjedh nga konkurrentët në sallë, në mënyrë rastësore, për çdo rubrikë. Pyetjet u lexuan publikisht para kandidatëve dhe pasi u formua teza me 100 pyetje, u fotokopjua në prani të tyre në sallën e zhvillimit të testimit. Teza ishte e njëjtë për të gjithë.

Testi zgjati 2.5 orë dhe morën pjesë 316 kandidatë. Përgjigjet në mënyrë skematike pa fjalë sipas teknikës scan tron, në përfundim, u lexuan nga pajisja në mënyrë elektronike, duke u bërë edhe renditja e tyre, në bazë të pikëve. 131 prej konkurrentëve arritën rezultatin mbi 60 për qind të pikëve në total duke u kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë të provimit.



Faza e parë e provimit të pranimit

Faza e dytë e testimit - testi profesional

Në datën 25.4.2022 u zhvillua faza e dytë e provimit të pranimit, në mjediset e Hollit të Pallatit të Kongreseve.

Teza për fazën e dytë kishte natyrën e një testi të thelluar profesional praktik-teorik dhe përfshinte pesë teza në fushat kryesore të së drejtës, përkatësisht, e drejtë civile, procedurë civile, e drejtë penale, procedurë penale. Teza e pestë që u zgjodh i takonte të drejtës së BE-së dhe ndërkombëtare publike, si dhe dy raste praktike, ku njëri ishte nga fusha e së drejtës private dhe procedurale civile dhe tjetri nga fusha e së drejtës penale dhe procedurale penale.

Kjo fazë e testimit vlerësohej maksimalisht me 350 pikë, ku secila tezë vlerësohej me 50 pikë. Kandidatët duhet të merrnin një minimum prej 60% të pikëve të testit profesional për t'u renditur në listën e kandidatëve me pikët më të larta.

Provimi në total u zhvillua në 4 orë, e ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë me 5 teza nga fushat e së drejtës u zhvillua në 2.5 orë dhe pjesa e dytë me 2 rastet praktike u zhvillua në 1.5 orë. Kjo ndarje u bë, për arsye se në momentin e zgjidhjes së rasteve praktike, kandidatët u pajisën me kodet përkatëse. Në fazën e dytë të testimit morën pjesë 131 konkurrentë.

Teza e plotë e përbërë nga 7 rubrika, të cilat ishin të njëjta për të gjithë kandidatët, u zgjodh në mënyrë rastësore nga konkurrentët në sallë që tërhoqën tezat vullnetarisht dhe u fotokopjuan në sallë.

Pas përfundimit të fazës së dytë të testimit, në bashkëpunim me monitoruesit ndërkombëtarë, u realizua procesi i sekretimit të zarfeve të mëdhenj dhe të vegjël që mbanin emrin e kandidatëve të mbyllur dhe vulosur në prani të tyre. Kutitë me zarfet e sekretuara, ku në një prej kutive ishte zarfi i vogël me emrat e konkurrentëve dhe në kutinë tjetër ishin zarfet me tezat e zgjidhura prej tyre, u mbyllën në kasafortën e Shkollës.

Po atë ditë, Këshilli Drejtues i Shkollës, me vendimin nr.11, datë 25.4.2022, miratoi komisionin e vlerësimit profesional të përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët u propozuan nga Drejtori i Shkollës nga radhët e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm me një përvojë mësimdhënieje në Shkollën e Magjistraturës jo më pak se 5 vjet.

Çdo anëtar i komisionit dorëzoi vlerësimet me pikët për çdo numër sekretimi të pyetjes që korrigjoi. Shkolla publikoi për konkurrentët rezultatet e vlerësimit me pikë për çdo numër sekretimi. Korrigjimi u realizua nga data 26 prill deri në 4 maj 2022. Më datë 26 prill u plotësua vetëm çelësi i zgjidhjes.

Pas daljes së rezultateve sipas numrave të sekretimit, si dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare sipas renditjes në pikë, u njoftuan të gjithë konkurrentët, që në datën 5 maj, ora 12.30 të paraqiteshin pranë Shkollës së Magjistraturës për të zhvilluar në mënyrë sa më transparente procedurën e përputhjes së numrave me emrat, për të mësuar renditjen e tyre sipas pikëve. (Kutitë me zarfet e vegjël, ku ishin të shënuar emrat, nuk dolën asnjëherë nga kasaforta që nga dita e testimit, por u morën vetëm në ditën e çsekretimit). Në prani të konkurrentëve u zhvillua procedura e hapjes së zarfeve të vegjël për të realizuar procesin e çsekretimit dhe për t'u njohur me rezultatet e secilit, duke lexuar emrat e pjesëmarrësve. Kjo procedurë u zhvillua njëkohësisht edhe online.

Renditja e rezultateve përfundimtare me pikë, nga rezultati më i lartë i arritur, te rezultati më i ulët, u shpall publikisht nëpërmjet afishimit në mjediset e Shkollës.

Pati disa kontestime të tezës të cilat u administruan sipas Rregullores dhe nuk sollën ndryshim të rezultateve.



Shpallja e rezultateve të vlerësimit, çsekretimi

6) Zhvillimi i testimit të shëndetit mendor dhe psikologjik

Me vendimin nr.11, datë 25.4.2022, Këshilli Drejtues i Shkollës miratoi Komisionin e Testimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik, i përbërë nga dy psikologë, dy psikiatër¹ dhe një pedagog i brendshëm në rolin e vëzhguesit nga Shkolla e Magjistraturës dhe një statisticien.

Ky testim u zhvillua me shkrim dhe me gojë, nëpërmjet vlerësimit në grup dhe vlerësimit mbi bazën e një interviste individuale.

Kandidatët për magjistratë u testuan mbi përshtatshmërinë e tyre me profesionin dhe jo mbi gjendjen e tyre shëndetësore.

Pas përfundimit të këtij testi, ku kandidatët u vlerësuan si të përshtatshëm për detyrën e gjyqtarit/ prokurorit/ ndihmësit ligjor (ndarje kjo në bazë të profilin që kandidatët kishin përzgjedhur)², Këshilli Drejtues me vendimin nr.13, datë 17.5.2022, miratoi listën e kandidatëve me rezultatet më të larta, duke u bazuar në tabelën e Vlerësimit të Testit Elektronik dhe tabelën e Komisionit të Vlerësimit të Testit Profesional, si dhe nga rezultatet e Komisionit të Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik.

Më datë 19 maj 2022, Shkolla e Magjistraturës përcolli listën e kandidatëve me pikët më të larta pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që përzgjedhën profilin e gjyqtarit, dhe listën e kandidatëve që kishin përzgjedhur profilin e prokurorit, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Duhet vënë në dukje se një pjesë e madhe e konkurrentëve që fituan të drejtën për të nisur Programin e Formimit Fillestar si ndihmës ligjorë hoqën dorë nga kjo e drejtë. Arsyeja që ata referuan lidhet me vullnetin e tyre për të marrë pjesë sërish në provimin hyrës me qëllim që të arrijnë rezultate të tilla që do t'i bëjnë fitues në profilin e magjistratit.

7) Publikimi i listës së fituesve

Publikimi i listës së kandidatëve është bërë sipas vendimeve të marra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të miratuara edhe nga Këshilli Drejtues.

8) Disa të dhëna statistikore të grupuara

a) Eksperienca e mëparshme në punë

Ky tregues është me interes për t'u paraqitur për shkak të një lidhje që mund të bëhet mes viteve në punë dhe mundësisë për të qenë fitues në provimin e pranimit. Kjo lidhje nuk është shkencore, por krijon një premisë për të diskutuar, për shkak se, për të qenë më objektive do të kërkonte edhe raportin mes konkurrentëve.

¹ Bazuar në listën e psikologëve dhe psikiatërve të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

² Zgjedhja e profilin u realizua në mjediset e Shkollës së Magjistraturës. Kjo procedurë u zhvillua duke filluar me kandidatit me pikët më të larta, i cili ka të drejtë të zgjedhë profilin dhe duke vazhduar me rend zbritës deri te kandidati i fundit i shpallur fitues.

Nisur nga të dhënat statistikore të kandidatëve që u shpallën fitues, për tre vite akademike të njëpasnjëshme, rezulton se pjesa më e madhe e tyre (86 kandidatë) kanë një eksperiencë të paktën 5-6 vjeçare. Në vend të dytë vijnë kandidatët me mbi 3–4 vite punë (70 kandidatë), në vend të tretë janë kandidatët që kanë mbi 10 vjet eksperiencë (34 kandidatë) dhe kandidatët me eksperiencë pune 7-9 vjet (34 kandidatë). Më poshtë, paraqitja grafike:




Informacion mbi eksperiencën profesionale të kandidatëve viti akademik 2020-2021; 2021-2022; 2022-2023

b) Statistika në bazë gjinie

Përsa i përket gjinisë në vitin e parë, në vitin e dytë dhe të tretë akademik 2022-2023 nga të dhënat statistikore rezulton se janë të regjistruar në Shkollë më shumë kandidate femra se sa meshkuj.

Më konkretisht, në vitin e parë janë 27 gjyqtare femra, 17 meshkuj, 18 prokuror femra dhe 8 prokuror meshkuj. Nga radhët e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë janë regjistruar në Shkollë 4 femra. Në vitin e dytë ndoqën Programin e Formimit Fillestar 22 kandidatë për gjyqtare femra, 10 kandidatë për gjyqtarë meshkuj, 18 kandidatë prokurore femra, 5 kandidatë prokurorë meshkuj. Në vitin e tretë ndoqën Programin e Formimit Fillestar 21 kandidatë gjyqtare femra, 19 kandidatë meshkuj, 19 kandidatë prokurore femra, 7 kandidatë prokurorë meshkuj.


Më poshtë, paraqitja grafike:



Informacion mbi ndarjen gjinore të kandidatëve për magjistratë, viti akademik 2022-2023

c) Fakulteti ku kanë zhvilluar studimet për drejtësi

Sipas të dhënave të kandidatëve, rezulton se në vitin akademik 2022-2023, 228 kandidatë kanë kryer studimet për drejtësi në fakultetet shqiptare, nga të cilët 209 kandidatë kanë kryer studimet në fakultetet publike dhe 19 në fakultetet e drejtësisë private. Janë diplomuar në fakultetet e drejtësisë jashtë shtetit vetëm 10 kandidatë. Më poshtë, paraqitja grafike nr. 4.



Informacion mbi studimet e kandidatëve për magjistratë, viti akademik 2022-2023

I. I. b Viti i parë

Viti akademik 2022-2023 filloi më 3 tetor 2022 dhe mësimi u zhvillua në 4 (katër) klasa, me një numër prej 17-21 kandidatë për çdo klasë.

Mësimi u zhvillua nga e hëna deri të premte, sipas orarit të përcaktuar në fillim të vitit akademik.

Kandidatët

Në përfundim të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshillat, statusin e kandidatit e fituan 76 **kandidatë**, prej të cilëve:

- 45 kandidatë për gjyqtarë³;
- 27 kandidatë për prokurorë⁴;
- 3 kandidatë për ndihmës ligjorë;
- 1 kandidat për këshilltar ligjor⁵.

Lëndët e vitit të parë:

Me vendimin nr. 27, datë 27.9.2022, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës miratoi Programin dhe Planin Mësimor të Formimit Fillestar për vitin e parë akademik 2022-2023, i cili parashikonte zhvillimin e 17 lëndëve, të grupuara si më poshtë:

GRUPI I PARË	GRUPI I DYTË
1. E drejta civile	E drejta e punës dhe e drejta e sigurimeve shoqërore
2. E drejta penale	E drejta ndërkombëtare private
3. Procedura civile	E drejta tatimore-doganore
4. Procedura penale	Menaxhimi i gjykatave/ prokurorive dhe çështjeve të saj
5. E drejta kushtetuese dhe Të Drejtat e Njeriut	Pronësia intelektuale

³ Bazuar në vendimin nr. 28, datë 26.6.2023 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, një prej kandidatëve për gjyqtarë, fitues në vitin 2021-2022, kaloi procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe mori statusin e kandidatit për magjistrat në fund të procesit mësimor për vitin akademik 2022-2023, vazhdoi provimet me kandidatët e vitit akademik 2022 – 2023, dhe kaloi me kandidatët për magjistratë profili gjyqtar, të cilët mbaruan vitin e parë 2022-2023. Bazuar në vendimin nr. 690, datë 15.11.2023, është kualifikuar për procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës edhe një kandidate për magjistrate profili gjyqtar, e cila ka ndjekur rregullisht programin mësimor për vitin akademik 2022-2023.

⁴ Bazuar në vendimin nr.333, datë 27.10.2023 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, një prej kandidatëve për prokuror, e kaloi procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe mori statusin e kandidatit për magjistrat në fillim të procesit mësimor për vitin akademik 2023-2024. Kandidatja kaloi në vitin e dytë dhe provimet e vitit të parë do t'i japë me kandidatët e vitit akademik 2023 – 2024.

⁵ Bazuar në vendimin nr. 21, datë 17.5.2023 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, një prej kandidatëve për këshilltar ligjor, fituese në vitin 2021-2022, kaloi procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe mori statusin e kandidatit për këshilltar ligjor në fund të procesit mësimor për vitin akademik 2022-2023, vazhdoi provimet dhe e përfundoi vitin akademik 2022-2023.

- | | |
|---------------------------------------|---------------------------|
| 6. E drejta e BE-së | Ndërmjetësimi, arbitrazhi |
| 7. E drejta administrative | |
| 8. Shkrim dhe arsyetim ligjor | |
| 9. Etika profesionale | |
| 10. E drejta familjare | |
| 11. E drejta tregtare dhe e kompanive | |

Zhvillimi i provimeve dhe vlerësimi i kandidatëve

Vlerësimi i kandidatëve për magjistratë gjatë vitit të parë u bë sipas skemës:

- a) Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik;
- b) Provimi përfundimtar i lëndës.

Totali i pikëve të vlefshme për vlerësimin e kandidatëve për çdo lëndë në fund të vitit/semestrit është 100 pikë, nga të cilat me 30-40 pikë vlerësoheshin detyrat e kursit, rastet praktike dhe diskutimet interaktive, mbi vlerësimin e vazhdueshëm, ndërsa provimi përfundimtar i lëndës vlerësohej me 60-70 pikë. Kufijtë maksimalë dhe minimalë të këtyre vlerësimeve u vendosën rast pas rasti nga çdo lëndë në varësi të natyrës dhe specifikave të saj. Këto limite u përcaktuan në çdo program lënde para fillimit të vitit akademik. Mënyra dhe skema e vlerësimit, si dhe pikavarazhi për secilën pjesë të vlerësimit u bë e ditur nga pedagogët përgjegjës të lëndëve për kandidatët në fillim të çdo kursi apo lënde, mbështetur në kriteret e vlerësimit.

Vlerësimi i kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë për provimin përfundimtar në Programin e Formimit Fillestar që ata zhvilluan në këtë vit u bë sipas skemës:

- a) Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik;
- b) Provimi përfundimtar i lëndës;
- c) Provimi me raste praktike.

Provimi përfundimtar me rastet praktike për kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë u zhvillua në datën 8 korrik 2022. Provimi u zhvillua me shkrim, i sekretuar dhe zgjati 4 orë. Teza ishte e ndërtuar me katër raste praktike nga fushat si vijon: a) pjesa I - E drejta private (civile, familjare e punës, tregtare) dhe e drejta procedurale civile; b) pjesa II - E drejta penale dhe procedurale penale; c) pjesa III - E drejta administrative materiale dhe e drejta procedurale administrative; ç) pjesa IV - E drejta publike (kushtetuese, të drejtat e njeriut, ndërkombëtare, legjislacioni i BE-së etj.).

Provimi u vlerësua nga një komision i përbërë nga katër anëtarë, nga radhët e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së Magjistraturës. Korrigjimi i provimit me shkrim u bë në një sallë të mbyllur (mjedis zyrtar) brenda godinës së Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, asnjë anëtar i komisionit nuk lejohej të merrte me vete fletët e provimit. Gjatë provimit, e gjithë salla u mbikëqyr nga një komision i ngritur për këtë qëllim nga Drejtoria e Shkollës. Nga Komisioni i Provimit nuk u konstatuan raste të mungesës së tezave në zarfet e mëdha. Zarfet e mëdhenj me fletët e përgjigjeve u hapën vetëm në ditët e korrigjimit në prezencë të komisionit të korrigjimit.

Shpallja e rezultateve në bazë të numrave të sekretimit u bë më datë 15 korrik po në këtë datë, u bë dhe hapja e zarfeve të vegjël me emrat në prani të kandidatëve për magjistratë, sipas teknikës *zoom meeting*. Pas marrjes së rezultateve, kandidatët verifikuan përgjigjet e tyre. Fletët e provimit u panë nga kandidatët, vetëm në sallën e vënë në dispozicion nga Shkolla. Nuk u lejua fotokopjimi ose marrja e fletëve të provimit.

Këshilli Pedagogjik miratoi vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Këto rezultate, pas miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, iu përcollën Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi këta kandidatë, sipas parashikimeve në ligjin nr. 98/2016 do të emërohen nga ana e këtij Këshilli në detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe në detyrën e ndihmësit ligjor pranë gjykatave të apelit.

Vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit, të cilët me vendimin e KLP-së do të ndiqte për një periudhë 9-mujore Programin e Formimit pranë Shkollës së Magjistraturës u bë sipas skemës:

- a) Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik;
- b) Provimi përfundimtar i lëndës;
- c) Provimi me raste praktike.

Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës miratoi rezultatet e këtij subjekti, të cilat u certifikuan, së bashku me raportin përfundimtar nga ana e Këshillit Drejtues. Në bazë të rezultateve të arritura nga subjekti, i cili mori mbi 70% të pikëve në provimin përfundimtar, ai arriti të kalojë mangësitë e parashtruara në Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në vijim, vendimi i Shkollës së Magjistraturës, iu përcoll, sipas parashikimeve në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Marzhet e vlerësimit

- Vlerësimi maksimal i vitit të parë për kandidatët për magjistratë është 2250 pikë dhe
- Vlerësimi maksimal i vitit të parë për kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjor është 2450 pikë.

Vlerësimi me shkallë i kandidatëve për magjistratë është:

- Niveli “Shkëlqyeshëm” është 100 (njëqind) pikë;
- Niveli “Shumë mirë” është 90-99 (nëntëdhjetë deri nëntëdhjetë e nëntë) pikë;
- Niveli “Mirë” është 70-89 (shtatëdhjetë deri tetëdhjetë e nëntë) pikë;
- Niveli “Mjaftueshëm” është 60-69 (pesëdhjetë deri gjashtëdhjetë e nëntë) pikë.

Rezultatet e arritura nga kandidatët në vitin e parë ishin të kënaqshme. Konkretisht, kandidatë që u vlerësuan “shumë mirë” janë 16; kandidatë që u vlerësuan “mirë” janë 49 kandidatë; kandidatë që u vlerësuan “mjaftueshëm” janë 5.

Nga 70 kandidatë për magjistratë të cilët u futën në provime:

- 22,8% prej tyre janë në nivelin e vlerësimit "Shumë mirë";
- 70% prej tyre janë në nivelin e vlerësimit "Mirë";
- 7,1% prej tyre janë në nivelin e vlerësimit "Mjaftueshëm".

Provimet përfundimtare të këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë sipas periudhave të miratuara janë zhvilluar:

1. 14 korrik 2023. E zhvilluan 2 kandidatë për ndihmëse ligjore dhe 1 subjekt rivlerësimi.
2. 5 tetor 2023. E zhvilluan 1 kandidate për këshilltare dhe 1 kandidate për ndihmëse ligjore.

Provimi u zhvillua me shkrim, me një tezë të ndërtuar me katër raste praktike nga fushat e mëposhtme: a) pjesa e parë - E drejta private (civile, familjare e punës, tregtare) dhe e drejta procedurale civile; b) pjesa e dytë - E drejta penale dhe procedurale penale; c) pjesa e tretë - E drejta administrative materiale dhe e drejta procedurale administrative; ç) pjesa e katërt - E drejta publike (kushtetuese, të drejtat e njeriut, ndërkombëtare, legjislacioni i BE-së etj.).

Rezultatet e arritura nga kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë ishin të kënaqshme. Katër kandidatët u vlerësuan me nivelin “mirë”.

I. I. c Viti i dytë

Viti akademik 2022-2023 filloi më 3 tetor 2022 dhe përfundoi më 9 qershor 2023. Në vitin e dytë, Shkolla e Magjistraturës pati 55 kandidatë për magjistratë.

Lëndët, gjyqet imituese dhe praktika paraprofesionale

Gjatë vitit akademik 2022-2023 kandidatët realizuan *kurse me natyrë formuese me karakter të përgjithshëm*, si “Psikologjia dhe komunikimi” dhe “Anglishtja ligjore”, *kurse me natyrë praktike*, si “Klinika ligjore dhe shkencore” dhe “Kriminalistika”, gjyqe imituese dhe praktikë paraprofesionale.

Ngarkesa mësimore ishte e shpërndarë si vijon:

- a) 48 orë me natyrë formuese me karakter të përgjithshëm dhe të specializuar në drejtim të rritjes së dijeve dhe aftësisë sa më praktik të kandidatëve;
- b) 1088 orë janë praktikë vëzhguese në organet e drejtësisë dhe institucione të tjera;
- c) 292 orë janë të formimit praktik në një ditë në javë në shkollë dhe/ose online në semestrin e parë dhe dy ditë në javë në shkollë dhe/ose online në semestrin e dytë.

Ndarja e ngarkesës së tyre në institucione dhe në auditor sipas semestrave u realizua si më poshtë:

- 4 ditë në javë në praktikë - 1 ditë në javë në Shkollë dhe/ose online - Semestri I;

- 3 ditë në javë në praktikë - 2 ditë në javë në Shkollë dhe/ose online- Semestri II.

Praktika paraprofesionale zgjati 9 muaj, duke filluar në muajin tetor 2022 deri në muajin qershor 2023 dhe u realizua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë dhe Vizita në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese.

Praktika, e konceptuar si lëndë më vete, përfundoi me shkrimin dhe dorëzimin e raporteve analizë mbi gjyqet dhe dosjet që ndjekin kandidatët. Këtë vit u dorëzuan 5 raporte sipas këtyre lëndëve kryesore: e drejtë civile, e drejtë penale, e drejtë administrative për gjyqtarët dhe 5 raporte penale për prokurorët.

Ky raport analizë bën lidhjen e teorisë me praktikën, duke bërë një krahasim të doktrinës me praktikën lidhur me një institut të caktuar të së drejtës.

Komponentët e këtij raporti janë si më poshtë vijon:

Përshkrimi i dosjes dhe seancave gjyqësore ku ky institut është hasur. Në këtë komponent, kandidatët për magjistratë paraqesin në radhë të parë në mënyrë sasiore dosjet dhe seancat gjyqësore që kanë ndjekur dhe ose këqyrur në lidhje me institutin e përzgjedhur prej tyre. Në këtë mënyrë evidentohet lehtësisht se çfarë angazhimi kanë pasur kandidatët gjatë praktikës, si dhe vlerësimi i tyre bëhet më i matshëm. Së dyti, në këtë komponent paraqitet një analizë e përmbledhur krahasuese mbi objektin dhe faktet relavante të çështjeve të ndjekura gjatë praktikës në lidhje me institutin përkatës. Në këtë mënyrë, kandidatët trajnohen për të identifikuar tipologjinë e fakteve që çojnë në zbatimin e një instituti të caktuar të së drejtës.

Analizë e përjasjes ndaj institutit të së drejtës në praktikë. Në këtë komponent kandidati për magjistrat paraqet një analizë të përmbledhur krahasuese të zhvillimit, kuptimit, interpretimit dhe zbatimit të institutit në praktikë. Analiza bazohet në dosjet dhe seancat gjyqësore të ndjekura, siç janë përshkruar në komponentin e mësipërm. Kandidati magjistrat analizon zhvillimin e institutit nga njëra çështje në tjetrën, veçoritë që ai paraqet në kontekste të ndryshme faktuale, përjasjen e gjyqtarit/prokurorit si dhe identifikon ndryshimet në përjasje, nëse ka të tilla. Çdo aspekt i analizës shoqërohet me një argument konciz. Në këtë komponent kandidatët trajnohen në aftësitë e tyre analitike.

Konkluzione. Raporti mbyllet me krahasimin e teorisë dhe praktikës, pra si është zbatuar teoria dhe si duhej të zbatohet. Konkluzione ku fokusi është te marrëdhënia ndërmjet “*law in the books*” dhe “*law in action*”. Gjithashtu, konkluzionet duhet të përmbajnë opinionin e kandidatëve në lidhje me ndryshimet e mundshme që ata kanë vënë re ndërmjet praktikës dhe teorisë. Pyetje të tilla, si p.sh.: përse mendoni që ka një ndryshim ndërmjet teorisë dhe praktikës, duhet të gjejnë përgjigje në këtë komponent. Kjo i mundëson kandidatët të reflektojnë për atë çfarë ata kanë mësuar në shkollë dhe çfarë kanë parë në praktikë.

Gjatë vitit akademik 2022-2023, u organizuan (6) gjashtë **gryqe imituese** për 6 grupe, pra 36 gryqe imituese gjithsej.

Kandidatët përgatitën aktet ligjore të nevojshme për realizimin e gjyqeve imituese, si dhe raportimeve për praktikën gjyqësore. Çdo gjyq imitues ka sesionin e tij të përgatitjes së akteve nga kandidatët. Aktet u përgatitën në mënyrë të pavarur nga kandidatët sipas ndarjes së punës në grupe dhe u diskutuan me pedagogët përgjegjës të praktikës paraprofesionale. Në auditor u nxorën konkluzionet e versioneve finale të tyre. Në rubrikën “Debat” kishte trajtime nga praktika gjyqësore, si dhe përgatitje të dosjeve për gjyqin imitues në një ose disa çështje konkrete gjyqësore, të tilla si për shembull: nga fusha e sigurimeve, e kriminalistikës, e mjekësisë ligjore, e kontabilitetit, e prokurimeve e të tjera. Një kurs përfshin më shumë se 2-4 çështje, në varësi të problematikës që lidhet me praktikën gjyqësore.



Pamje nga një gjyq imitues, viti i dytë 2022-2023

Vlerësimi i kandidatëve në vitin e dytë

Në vitin e dytë u vlerësuan në mënyrë të vazhdueshme tre komponentë:

1. Komponenti i parë lidhet me kurset në funksion të formimit të përgjithshëm dhe kurset e specializuara praktike. Pikët maksimale të komponentit të parë të vitit të dytë janë 450 pikë;
2. Komponenti i dytë i vlerësimit lidhet me formimin e aftësive praktike në drejtimet e mëposhtme:
 - a) Mënyra e vlerësimit të gjyqeve imituese, diskutimeve dhe debateve lidhur me çështje të praktikës gjyqësore, si dhe dosjeve të përgatitura gjatë vitit. Realizimi i gjyqeve imituese, debateve, dosjeve të përgatitura dhe vlerësimi, bëhet nga pedagogët përgjegjës të praktikës në Shkollë. Vlerësohet me 100 pikë me koeficient vështirësie 2.4 (dy pikë katër);
 - b) Mënyra e vlerësimit të praktikës në gjykata dhe prokurori: (Vlerësimi i praktikës bëhet nga përgjegjës/përgjegjësit e stazhit paraprofesional nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në fund të stazhit, përgjegjësi i stazhit jep një vlerësim narrativ për

veprimtarinë që ka mbuluar kandidati, duke u bazuar në kriteret e vlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, si aftësitë profesionale, që kanë të bëjnë me nivelin e njohurive dhe aftësive ligjore, aftësive organizative, të vlerësuara në bazë të veprimtarisë së kandidatit gjatë ditëve të praktikës, si dhe një karakteristikë të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, si edhe mbi aftësitë personale dhe angazhimin personal të tij.

2.1 Praktika për kandidatët gjyqtarë vlerësohet nga mentorët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Dhoma Civile + Dhoma Penale + Gjykata Administrative e shkallës së parë nga 150 pikë secili mentor respektiv. Totali i vlerësimit nga mentorët në fund të praktikës do të jetë 450 pikë me koeficient vështirësie 1.5 (një pikë pesë) dhe në total me 675 pikë.

2.2 Praktika për kandidatët prokurorë vlerësohet nga mentorët e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me 250 pikë, nga mentorët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Dhoma Penale me 150 pikë dhe nga mentorët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Dhoma Civile me 50 pikë. Totali i vlerësimit nga mentorët në fund të praktikës do të jetë 450 pikë me koeficient vështirësie 1.5 (një pikë pesë) dhe në total me 675 pikë.

c) Mënyra e vlerësimit të praktikës përmes raporteve analizë të zhvilluara në fushat kryesore. Vlerësimi i raporteve analizë u bë nga pedagogët e lëndëve sipas fushave kryesore. Raportet analizë u sekretuan për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit dhe u vlerësuan me nga 100 pikë secila fushë. Vlerësimi total i raporteve analizë ishte me 400 pikë, me koeficient vështirësie 2.15 dhe u bë nga pedagogët e brendshëm përgjegjës në bashkëpunim me pedagogët e lëndëve përkatëse.

Vlerësimi total i të gjithë komponentëve të vitit të dytë është 2225 pikë.

I. I. d Provimi përfundimtar pas vitit të dytë

Provimi përfundimtar për vitin akademik 2022-2023 në vitin e dytë u zhvillua në datat 21 dhe 22 qershor 2023.

Provimi u zhvillua me shkrim, me një tezë të ndërtuar me katër raste praktike nga fushat e mëposhtme: a) pjesa e parë - E drejta private (civile, familjare e punës, tregtare) dhe e drejta procedurale civile; b) pjesa e dytë - E drejta penale dhe procedurale penale; c) pjesa e tretë - E drejta administrative materiale dhe e drejta procedurale administrative; ç) pjesa e katërt - E drejta publike (kushtetuese, të drejtat e njeriut, ndërkombëtare, legjislacioni i BE-së etj.).

Provimi përfundimtar u vlerësua nga një komision i përbërë nga gjashtë anëtarë, nga të cilët katër anëtarë nga radhët e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së Magjistraturës, përgjegjës të lëndëve kryesore dhe nga një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratuar me vendimin nr.23, datë 17.5.2023 të Këshillit Drejtues, “Për caktimin e anëtarëve të komisionit të provimit përfundimtar të kandidatëve të vitit të dytë për vitin akademik 2022-2023”.

Provimi me raste praktike u bë me shkrim, përgjatë 4 orëve, duke iu nënshtruar procesit të sekretimit, me qëllim ruajtjen e objektivitetit. Procedura e sekretimit ishte e njëjtë si provimi i pranimit.

Korrigjimi i provimit me shkrim u bë në një sallë të mbyllur (mjedis zyrtar) brenda godinës së Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, asnjë anëtar i komisionit nuk u lejua të merrte me vete fletët e provimit. Gjatë provimit, e gjithë salla u mbikëqyr nga një komision i ngritur për këtë qëllim nga Drejtoria e Shkollës. Nga Komisioni i Provimit nuk u konstatuan raste të mungesës së tezave në zarfet e mëdha.

Zarfet e mëdhenj me fletët e përgjigjeve u hapën vetëm në ditët e korrigjimit në prezencë të komisionit të korrigjimit.

Shpallja e rezultateve në bazë të numrave të sekretimit u bë më datë 6 korrik 2023. Po në këtë datë, u bë dhe hapja e zarfeve të vegjël me emrat në prani të kandidatëve për magjistratë.

Pas marrjes së rezultateve, kandidatët verifikuan përgjigjet e tyre. Fletët e provimit u panë nga kandidatët, vetëm në sallën e vënë në dispozicion nga Shkolla. Nuk u lejua fotokopjimi ose marrja e fletëve të provimit.

Vlerësimi total i të gjithë komponentëve të vitit të parë dhe të dytë u miratua në Këshillin Pedagogjik dhe është shumatorja e:

- 2250 pikëve të vitit të parë;
- 2225 pikëve të vitit të dytë dhe
- 200 pikëve të provimit përfundimtar.

Totali i vlerësimit të dy viteve të para është 4675 pikë.

Rezultatet e arritura nga 55 kandidatë në vitin e dytë ishin të kënaqshme. Kandidatët e vitit të dytë janë vlerësuar 100% me nivelin “shumë mirë”.

I. I. e Viti i tretë

Në vitin akademik 2022–2023, Shkolla e Magjistraturës formoi 66 kandidatë për magjistratë në Programin e Formimit Fillestar.

Plani mësimor i vitit të tretë, bazuar në ligjin nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”; ligji nr. 115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, u miratua me Vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, praktika profesionale zgjati 12 muaj, duke filluar në muajin korrik 2021 dhe duke përfunduar në muajin qershor 2022.

Kandidatët për magjistratë të vitit të tretë, kryen praktikën profesionale pranë gjykatave dhe prokurorive të shkallës së parë, të udhëhequr nga një trup magjistratësh udhëheqës, të cilët realizuan vlerësimin profesional dhe etik të secilit kandidat, bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara në ligj.

Për këtë vit akademik 2022 – 2023, praktikën profesionale kandidatët për magjistratë e kryen përkatësisht:

Kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ndarë në Dhomën Civile dhe Penale, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në perioda të ndryshme, Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë;

Kandidatët për prokurorë, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier.

Vlerësimi në vitin e tretë

Në vitin e tretë, vlerësimi i kandidatëve magjistratë u krye nga magjistrati udhëheqës. Magjistrati udhëheqës bëri vlerësimin etik dhe profesional, si dhe të cilësisë së kandidatëve për magjistratë, me qëllim garantimin e një formimi sa më të mirë të tyre.

Kriteret e vlerësimit bëhen në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 71 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”:

- a) aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Vlerësimi i kandidatëve për magjistratë bëhet sipas kategorive që vijojnë:

- a) “shkëlqyeshëm”, në rast të një performance etike dhe profesionale jashtëzakonisht të mirë⁶;
- b) “shumë mirë”, në rast të një performance etike dhe profesionale mbi mesataren⁷;
- c) “mirë”, në rast të një performance etike dhe profesionale mesatare⁸;
- ç) “mjaftueshëm”, në rast të një performance etike dhe profesionale nën mesataren;
- d) “i pamjaftueshëm”, në rast të një performance etike dhe profesionale jashtëzakonisht të dobët⁹.

Vlerësimi për secilin kandidat për magjistrat bëhet nga tre magjistratë udhëheqës, përkatësisht sipas periudhave katër mujore në të cilat realizohet praktika profesionale.

⁶ Vlerësimi i përgjithshëm “shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

⁷ Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tri kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre dhe, në çdo rast, nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar “i pamjaftueshëm”. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe të prokurorisë” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë”.

⁸ Vlerësimi i përgjithshëm “mirë” jepet në rastin kur aftësitë e magjistratit vlerësohen “mirë” për dy kriteret dhe “mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në pikën 3, të këtij neni. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore ose të prokurorisë” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” duhet të vlerësohen të paktën “shumë mirë”.

⁹ Vlerësimi i përgjithshëm “i pamjaftueshëm” jepet në këto raste: a) kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kriteret; b) kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” dhe jo më shumë se “mirë” për dy kriteret e tjera. Në çdo rast, vlerësimi “i pamjaftueshëm” nuk i jepet magjistratit nëse kryetari i gjykatës e ka vlerësuar magjistratin “shumë mirë”.

Çdo magjistrat udhëheqës vlerëson me 100 pikë kandidatin për magjistrat, në bazë të kritereve dhe niveleve të përcaktuara në ligjin, “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”.

Në total, vlerësimi i bërë nga tre magjistratët udhëheqës është 300 pikë dhe ka koeficient vështirësie 2.

Rezultatet e arritura nga 66 kandidatë të cilët përfunduan vitin e tretë janë:

- 57 kandidatë për magjistratë janë vlerësuar me nivelin “shkëlqyeshëm”;
- 9 kandidatë për magjistratë janë vlerësuar me nivelin “shumë mirë”.

Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve për magjistratë

Këshilli Pedagogjik bëri vlerësimin përfundimtar për të tri vitet, në bazë të rezultateve të provimeve të vitit të parë, të rezultateve të vitit të dytë, rezultateve të provimit përfundimtar në fund të vitit të dytë, si dhe pikëve të vitit të tretë të stazhit profesional, sipas sistemit me 5 nivele, mbi bazën e një renditje përfundimtare të tyre me pike për 66 kandidatë për magjistratë.

Vlerësimi përfundimtar i përgjithshëm është 5275 pikë.

Drejtori i Shkollës i paraqiti një raport Këshillit Drejtues, së bashku me Vendimin e Këshillit Pedagogjik mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve për magjistratë të diplomuar. Gjithashtu, Këshilli Pedagogjik hartoi një propozim për vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë dhe programin e udhëheqësve, vlerësimin e performancës së stazhit profesional, të cilin ia paraqiti Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues, me vendimin nr.27, datë 26.6.2023, “*Për miratimin e vlerësimit përfundimtar dhe listës së renditjes së kandidatëve për magjistratë pas përfundimit të viti të tretë dhe raportit të vlerësimit përfundimtar të kandidatëve për magjistratë të vitit të parë, dytë dhe provimit përfundimtar të vitit të dytë*” miratoi renditjen përfundimtare të kandidatëve magjistratë të diplomuar 2020 – 2023.

Shkolla publikoi listën e kandidatëve magjistratë, të diplomuar në Formimin Fillestar për periudhën 2020-2023 në faqen zyrtare www.magjistratura.edu.al, duke bërë publike edhe renditjen përfundimtare të tyre.

Më datë 23 qershor u organizua ceremonia e diplomimit të kandidatëve për magjistratë të cilët përfunduan programin trevjeçar të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës për brezin 2020 – 2023. Ceremonia u zhvillua në mjediset e amfiteatrit në godinën “Poli i Drejtësisë”.

Rezultatet e arritura nga 66 kandidatë të cilët përfunduan Programin e Formimit Fillestar 2020-2023 janë:

47 kandidatë për magjistratë janë vlerësuar me nivelin “shumë mirë”; 19 kandidatë për magjistratë janë vlerësuar me nivelin “mirë”.

I. I. f Përmbushja e objektivave mësimore

Procesi i mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës gjatë vitit akademik 2022 – 2023 arriti të përmbushte objektivat dhe synimet që ai ka, bazuar në programin për aftësitë e magistratit. Konkretisht, ky vit synoi objektivat dhe kompetencat si më poshtë vijojnë:

Synimi 1: Njohuri të thelluara procedurale/materiale, nga jurisprudenca vendase/evropiane

I. Njohuri të qëndrueshme dhe të thelluara për të drejtën dhe vlerësimi i saj

Kandidati magjistrat duhet:

1. të zotërojë njohuri të qarta dhe të thelluara teorike mbi konceptet, parimet dhe institutet kryesore, në të drejtat: private, penale, administrative, publike, të ndërthurura me aspektin praktik, duke identifikuar dallimet midis instituteve në fushat e ndryshme të së drejtës.

II. Kuptim i qartë dhe njohuri të thelluara për jurisprudencën dhe vlerësimi i saj

Kandidati magjistrat duhet:

1. të njohë dhe të vlerësojë në mënyrë të thelluar qëndrimet dhe interpretimet me vlerë doktrinale në praktikën gjyqësore brenda vendit dhe të ndjekë në mënyrë të përditësuar jurisprudencën evropiane të zbatueshme për kontekstin shqiptar (GJEDNJ, GJED etj.).

III. Zbatimi i së drejtës nga pikëpamja praktike

Kandidati magjistrat duhet:

1. të identifikojë çështjet ligjore që ngrihen në një situatë faktike, të përcaktojë bazën ligjore të saj dhe të identifikojë dhe të jetë i vetëdijshëm për synimet legjislativë;
2. të analizojë faktet/provat, të përcaktojë se cilat prej tyre janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, dhe të evidentojë implikimet sociale në zbatimin e së drejtës.

Synimi 2: Aftësim në veprimet/hetimet paraprahe dhe përgatitjen e seancës gjyqësore

I. Çështjet procedurale

Kandidati magjistrat duhet:

1. të vlerësojë se kur dosja i përmbush kriteret formale dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas rastit.

II. Përgatitjet për thelbin e çështjes

Kandidati magjistrat duhet:

1. të studiojë dosjen/materialin për të përcaktuar natyrën e konfliktit/ngjarjes/çështjes, faktet kyçe, si dhe bazën ligjore përkatëse (ligjin, praktikën gjyqësore, doktrinën, politikat gjyqësore);
2. të përcaktojë provat dhe t'i çmojë ato në funksion të zgjidhjes së çështjes/marrjes së vendimit.

III. Vlerësimi paraparak

Kandidati magjistrat duhet:

1. të përcaktojë radhën e veprimeve paraprahe/përgatitore si dhe ato të seancës gjyqësore, duke vlerësuar edhe mundësinë e zbatimit të alternativave të zgjidhjes jashtëgjyqësore;
2. të përcaktojë kontekstin shoqëror të çështjes.

IV. Bashkëpunimi procedural

Kandidati magjistrat duhet:

1. të bashkëpunojë dhe/ose të drejtojë kolegët, grupin hetimor, palët.

Synimi 3: Aftësim në debatin gjyqësor

I. *Çështjet procedurale*

Kandidati magjistrat duhet:

1. të organizojë debatin duke shmangur rrethanat e papritura e duke komunikuar paraprakisht me pjesëmarrësit e procesit;
2. të zgjidhë çështjet drejt, pa vonesë, duke respektuar të drejtat e palëve;
3. të vlerësojë mundësinë e zbatimit të alternativave jashtëgjyqësore;
4. të respektojë standardin e arsytimit të vendimeve të ndërmjetme në përgjigje të kërkesave të palëve përgjatë ecurisë së procesit gjyqësor.

II. *Për thelbin e çështjes*

Kandidati magjistrat duhet:

1. të përmbledhë në mënyrë të saktë dhe të bëjë pyetje për të kontrolluar kufijtë e kuptimit të çështjes, për të marrë informacionin që i mungon ose është i paqartë për fakte dhe këndvështrime me rëndësi për gjykimin duke ndërtuar strategjinë e pyetjeve dhe ballafaqimeve për të sqaruar mospërputhjet.

Synimi 4: Aftësim në përgatitjen e akteve dhe marrjen e vendimeve

I. *Çështjet formale*

Kandidati magjistrat duhet:

1. të vlerësojë kompetencën dhe pranueshmërinë në çështjet civile, penale dhe administrative;
2. të përcaktojë dhe të vlerësojë faktet thelbësore të çështjes, me ndikim në përgatitjen e akteve dhe në marrjen e vendimit, në raport me kontekstin shoqëror të çështjes;
3. të shprehet qartë dhe saktë, me një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme për palët.

II. *Në dhomë këshillimi/në grup hetimor*

Kandidati magjistrat duhet:

1. të dëgjojë, reagojë dhe komentojë në mënyrë efektive e konstruktive idetë e shprehura nga kolegët, brenda kohës së caktuar, duke propozuar ndryshimet që i çmon të nevojshme, të mbrojnë pikëpamjen e tij/saj me vendosmëri dhe, kur është e nevojshme, të heqë dorë prej saj;

III. *Çështjet e thelbit të çështjes*

Kandidati magjistrat duhet:

1. të përcaktojë, debattojë dhe zbatojë ligjin procedural dhe material, jurisprudencën dhe doktrinën në çështjen konkrete;
2. të analizojë provat, të arsyetojë drejt lidhur me faktet që ato provojnë dhe të dallojë qartë pretendimet/pikëpamjet e paraqitura nga palët nga faktet mbi të cilat bazon vendimin;
3. të aftësohet për përgatitjen e një vendi të strukturuar dhe të argumentuar qartë duke u mbështetur në përfundimet e arritura, lidhur me çështjet e faktit dhe të ligjit.

Synimi 5: Forcimi i vetëdijes shoqërore të magjistratit, integritetit dhe etikës profesionale

I. *Funksioni i magjistratit*

Kandidati magjistrat duhet:

1. të tregojë qëndrim të paanshëm dhe me integritet dhe të ketë qëndrim profesional të pavarur për të përballuar presionet e çdo lloji;
2. të ketë sjellje etike profesionale dhe t'i shmangët konfliktit të interesit;

3. të aftësohet në marrjen e vendimit në çështjen konkrete duke pasur në vëmendje efektin shoqëror të saj;
4. të jetë i ndërgjegjshëm për funksionin e tij/saj si magjistrat, gjithashtu edhe për sjelljen shoqërore ose private dhe të tregojë përgjegjësinë e tij/saj në jetën e tij/saj profesionale dhe private.

II. Profesionalizmi

Kandidati magjistrat duhet:

1. të familjarizohet shpejt me njohuritë ligjore dhe të analizojë cilat rrethana të tjera mund të ndikojnë në vendim dhe duke vepruar kështu, të marrë parasysh politikat dhe ligjin.

III. Politikat penale/civile/administrative

Kandidati magjistrat duhet:

1. të gjejë dhe zbatojë politikën përkatëse në një çështje konkrete;
2. të marrë pjesë në diskutimet dhe propozimet për ndryshimet e legjislacionit në fushën e drejtësisë, të drejtojë një debat ligjor duke marrë iniciativën dhe duke nxitur sjelljen në grup.

Synimi 6: Bashkëpunim, transparencë dhe komunikim

I. Bashkëpunimi

Kandidati magjistrat duhet:

1. të japë vlerësim konstruktiv dhe efektiv për kolegët dhe të vlerësojë ndikimin e veprimeve/sjelljeve të tij/saj mbi të tjerët;
2. të jetë transparent duke respektuar diversitetin, konfidencialitetin dhe parimet e mbrojtjes së të dhënave personale;
3. të komunikojë me një gjuhë të qartë e të përshtatshme dhe të hapur me kolegët, të dëgjojë opinionet e kundërta, të jetë mendjehapur dhe të reflektojë mbi kritikën që i bëhet;
4. të kuptojë sjelljet dhe veçoritë e pjesëmarrësve dhe të vetëpërmbahet dhe të shmangë çdo lloj nënkuptimi apo kuptimi tjetër nga qëllimi kryesor.

I. I. g Stafii pedagogjik

Shkolla e Magjistraturës i kushton një rëndësi të veçantë stafit pedagogjik që përzgjedh duke synuar të përmbushë standarde ekselence në mësimdhënie. Kushtet dhe kriteret për të qenë pedagog në Shkollë janë të parashikuara në ligj dhe procedura e përzgjedhjes së tyre është pjesë e rëndësishme e Rregullores së Brendshme të Shkollës.

Në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2022-2023 u angazhuan 8 (tetë) pedagogë të brendshëm dhe 47 pedagogë të jashtëm, 5 asistent pedagogë, si dhe 17 specialistë nga të cilët 9 gjyqtarë dhe prokurorë në sistem.

Në lëndët kryesore përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar është edhe më e lartë, konkretisht 13 gjyqtarë/prokurorë në 17 pedagogë, ose 76.47%.

Në vitin e dytë kontribuan 1 (një) pedagoge e jashtme dhe 6 (gjashtë) specialistë të fushës nga të cilët 50% gjyqtarë/prokurorë.

Shkolla gjithashtu, miratoi edhe pedagogë në dispozicion për të ofruar ekspertizë në momentet kur është vlerësuar e nevojshme nga pedagogët e lëndës. Pedagogët në dispozicion kanë qenë 15, nga të cilët 10 gjyqtarë/prokurorë në detyrë, ose 66.67%.

Sa i përket angazhimit të stafit pedagogjik me grada dhe tituj shkencorë, 22.83% e të gjithë stafit pedagogjik është me gradën Doktor/Profesor i asociuar/Profesor.

I. I. i Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Shkolla e Magjistraturës ka marrëdhënie bashkëpunimi, shkëmbimi informacioni, analizimi dhe ndihme reciproke me KLGJ-në dhe KLP-në. Në funksion të mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë ka pasur një shkëmbim intensiv informacioni dhe idesh me KLGJ-në dhe KLP-në lidhur me Programin e Formimit Fillestar. Konkretisht:

- Shkolla është konsultuar me Këshillat lidhur me kuotat për provimin e pranimit;
- Shkolla ka përcjellë të dhënat dhe dosjet për konkurrentët për provimin e pranimit dhe ka reflektuar opinionet e këshillave lidhur me listën finale të konkurrentëve që do të nisnin procesin mësimor;
- Shkolla ka pritur konfirmimet nga këshillat për përshtatshmërinë e figurës dhe pasurinë për konkurrentët përpara se të merrnin statusin e kandidatit për magjistrat/këshilltar/ndihmës ligjor. Këshillat nuk arritën të dërgojnë në Shkollë konfirmimet sipas afateve të parashikuara në ligj, megjithatë Shkolla lejoi që konkurrentët fitues të ndjekin programin mësimor;
- Shkolla ka përcjellë vendimet lidhur me vlerësimet e Këshillit Pedagogjik për kandidatët e Programit të Formimit Fillestar dhe vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit;
- Këshillat kanë bashkëpunuar ngushtësisht me Shkollën për realizimin me sukses të praktikës profesionale. Konkretisht, ata miratuan: a) caktimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si gjykata dhe prokurori që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë; b) caktimin e magjistratëve udhëheqës për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi; c) angazhimin e magjistratëve udhëheqës për pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës; ç) ndarjen e kandidatëve për magjistratë në gjykata dhe prokurori për kryerjen e praktikës profesionale për vitin akademik 2022 – 2023; d) vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve për magjistratë nga magjistratët udhëheqës nëpërmjet formularëve të vlerësimit, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara në ligj¹⁰.
- Shkolla e Magjistraturës organizoi disa aktivitete trajnuese për ndërgjegjësimin e magjistratëve udhëheqës për rëndësinë e vlerësimit, mënyrën e vlerësimit dhe plotësimin e formularëve të vlerësimit.

¹⁰ Magjistrati udhëheqës bëri vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat magjistrat çdo 2-mujor, 4-mujor dhe tabelën përfundimtare të vlerësimit, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit, të përcaktuara në ligj.

I.II PROGRAMI I FORMIMIT VAZHDES

Programi i Formimit Vazhdes në Shkollën e Magjistraturës është një program i specializuar, që synon t'i shërbejë përmirësimit të cilësisë së drejtësisë dhe bazohet në nevojat e sistemit për trajnim. Ky program përfshin një proces të gjerë analize dhe konsultimi si ndërmjet strukturave dhe organeve vendimmarrëse të Shkollës, edhe me organet kryesore të sistemit të Drejtësisë, KLGJ-në, KLP-në, MD-në, Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, ILD-në dhe gjykatat/prokuroritë e të gjitha niveleve. Kontributorë të vazhdueshëm në këtë program janë edhe partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë të cilët e kanë asistuar SHM-në si në ekspertizë, edhe në çështje organizimi apo logjistike. Synimi është që të arrihen të përçohen njohuri të thelluara, të analizohen situata konkrete ligjore, të krijohet mundësia e zgjidhjes së kontradiktave mes ligjit dhe praktikës me qëllim unifikimin e zgjidhjes së çështjeve për të cilat ka qëndrime të ndryshme në praktikë, duke ndikuar kështu në tërësi në rritjen profesionale të pjesëmarrësve në aktivitetet e organizuara.

Programi i Formimit Vazhdes synon në forcimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë edhe përsa i takon administratës gjyqësore, kancelarëve dhe nëpunësve të tjerë gjyqësorë.

Gjithashtu, pjesë e kurseve janë jo vetëm ato që lidhen me ligjin dhe praktikën gjyqësore, por një vëmendje e veçantë ju kushtohet edhe aftësive të komunikimit, etikës, sjelljes, menaxhimit të kohës etj.

Viti akademik 2022 – 2023 ka qenë sfidues për Formimin Vazhdes përsa i takon mundësisë së magistratëve në sistem për të marrë pjesë në aktivitetet trajnuese të organizuara nga Shkolla pasi për shkak të vakancave të krijuara në sistem në kuadër të procesit të vettingut, mbingarkesa në punë si për gjyqtarët, edhe prokurorët ka qenë shumë e madhe.

Është për t'u evidentuar se, me gjithë vështirësitë, interesi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të marrë pjesë në formimin vazhdes ka qenë i vazhdueshëm. Kjo reflektohet edhe në aplikimet e tyre për vitin akademik 2022-2023, proces ku ata kanë qenë aktivë, jo vetëm si aplikues për pjesëmarrës, por edhe me ide për tema të ndryshme dhe me gatishmërinë për të ofruar ekspertizë.

I.II. a Analiza e nevojave për trajnim dhe miratimi i kalendarit të aktiviteteve trajnuese

Përgatitja për Programin e Formimit Vazhdes nisi me analizën e nevojave për trajnim, proces që nisi në muajin prill 2022, i koordinuar nga Drejtori i Shkollës në bashkëpunim me Pedagogun Përgjegjës të Programit të Formimit Vazhdes, stafin e brendshëm pedagogjik dhe stafin administrativ.

Përmes kryetarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit, si dhe të prokurorëve të rretheve gjyqësore dhe të apelit dhe lehtësuar nga sistemi “Moodle”, i vendosur në dispozicion nga Shkolla e Magjistraturës”, u koordinua marrja e nevojave dhe kërkesave për tematikat e Programit të Formimit Vazhdes të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend.

Programi dhe kalendarit u hartuan me kujdes, duke respektuar një metodologji eficiente dhe bashkëkohore, duke ndërthur mënyra të ndryshme marrje të informacionit dhe nevojave të sistemit. Hapat që u ndoqën ishin:

- mbledhja dhe analizimi i pyetësorëve të pjesëmarrësve dhe raporteve të ekspertëve/lehtësuesve pas çdo aktiviteti trajnues;
- evidentimi dhe analizimi i interesit të shfaqur gjatë realizimit të diskutimeve të drejtpërdrejta gjatë sesioneve trajnuese ose aktiviteteve specifike të natyrës së *brainstorming* të përcjella nga ekspertët ose/dhe lehtësuesit;
- mendimi i të gjitha institucioneve të interesuara të sistemit të drejtësisë;
- konsultimi me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë të Shkollës;

- harmonizimi me legjislacionin e ri që ndikon në veprimtarinë e drejtësisë dhe në kuadrin e përfaqësimit me legjislacionin e BE-së, dokumentet strategjike, reformën ligjore dhe institucionale, si dhe angazhimeve të marra nga Shqipëria, në kuadër të procesit të Integritetit Evropian, njohjes me detyrimet që burojnë nga instrumente ndërkombëtare të ratifikuara;
- konsultimi me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe të GJED-së etj.

Pas mbledhjes së të gjitha nevojave për Formimin Vazhdues, përgjegjësi i Programit të Formimit Vazhdues, në bashkëpunim me stafin e Sektorit të Formimit Vazhdues u kujdes për hartimin e projekt programit tematik, i cili u diskutua fillimisht nga Këshilli Pedagogjik dhe Drejtori i Shkollës dhe më tej u diskutua e u miratua në Këshillin Drejtues.

Në përcaktimin e numrit të aktiviteteve u mbajt në konsideratë edhe e drejta/detyrimi i magistratëve për të marrë pjesë në të paktën pesë ditë të plota në vit (ligji nr. 96/2016, neni 5, pika 3).

Këshilli Drejtues miratoi Projekt Programin Tematik me vendimin nr. 20, datë 29.6.2021, program i cili iu dërgua Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të prokurorive të rretheve dhe të apeleve.

Kryetarët e gjykatave dhe prokurorive dërguan listat e pjesëmarrësve, të përfuara përmes aplikimit elektronik me anë të sistemit “Moodle” mbi bazën e formularëve të aplikimit për çdo temë.

Hartimi i kalendarit të trajnimeve për vitin akademik 2022-2023 u përmbyll pas analizës së aplikimeve të pjesëmarrësve dhe iu dërgua sërish Këshillit Pedagogjik dhe Këshillit Drejtues.

Kalendari me aktivitetet trajnuese u miratua nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 36, datë 20.9.2023 dhe u publikua menjëherë në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratuan pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Formimin Vazhdues, sipas këtij kalendarit.

I. II. b Metodologjia e aktiviteteve trajnuese

Viti akademik 2022-2023 shënoi rikthim të trajnimeve në auditor. Pjesa më e madhe e aktiviteteve trajnuese u zhvillua në ambientet e Shkollës së Magjistraturës duke u bazuar sërish në metodologjinë që lejon interaktivitetin dhe diskutimin mes panelit trajnues dhe pjesëmarrësve.

Zhvillimi i aktiviteteve trajnuese në sallë është më i preferuar për përdoruesit e tij, pasi krijon mundësinë për të qenë aktivë gjatë aktivitetit trajnues.

Ekspertët/lehtësuesit/moderatorët e Formimit Vazhdues, përmes aktiviteteve të trajnimit të trajnerëve, janë udhëzuar që të kujdesen për mënyrën sesi realizohet interaktiviteti në sallë, që ndërhyrjet të jenë konstruktive, të shpërndara dhe jo dominuese, duke i lënë hapësirën e nevojshme diskutimeve nga pjesëmarrësit.

Diskutimet bazohen në çështjet e prezantuara dhe në pyetjet që ngrenë vetë ekspertët, apo pjesëmarrësit në aktivitet. Përgjigjja e tyre nxirret nga diskutimi i vendimeve unifikuese, diskutimi i çështjeve praktike dhe kazuseve, shkëmbimi i eksperiencave, ndarja e njohurive, analiza e ligjit dhe krahasimi me ligjet e shteteve të tjera, e të tjera.

Ndaj çdo paneli u kërkua që të kishte bashkëpunim mes trajnerëve me qëllim evidentimin e çështjeve që do të trajtonte secili dhe rolin që do të merrnin në trajnim.

Përgjatë vitit akademik 2022-2023, Shkolla e Magjistraturës, sidomos Programi i Formimit Vazhdues pati një qasje përkundrejt metodave të reja të zhvillimit të aktiviteteve trajnuese, siç janë ato të e-learning, si edhe metoda të tjera të marra edhe nga modele të Shkollave Ndërkombëtare.


Disa nga risitë që solli kjo metodologji për Programin e Formimit Vazhdues janë zhvillimi i quiz-eve online me vetëvlerësim automatik, zhvillimi i lojërave të ndryshme interaktive, publikimi i menjëhershëm i këtyre quiz-eve shoqëruar me materialet përkatëse të aktivitetit trajnues në website-in zyrtar për të gjithë ata që nuk mundën ta ndjekin aktivitetin në sallë. Një tjetër risi janë zhvillimi i formularëve të vlerësimit online, nëpërmjet një barkodi i cili vendoset në dispozicion dhe mund të skanohet nga çdo aparat celular. Duke qenë se ishte viti i parë që futen këto elemente, u vazhdua njëkohësisht edhe me formularët e vlerësimit në formë fizike, për ta lehtësuar këtë proces. Në lidhje me këto elemente të reja të përfshira në metodologjinë e aktiviteteve trajnuese, u zhvillua edhe një trajnimin për lehtësuesit e rinj të përfshirë në Programin e Formimit Vazhdues, mbështetur edhe nga specialistët e IT-së të stafit të brendshëm administrativ.

Për çdo aktivitet trajnues, ekspertëve dhe lehtësuesve ju është kërkuar të depozitojnë pranë Shkollës së Magjistraturës temën e përgatitur në kopje fizike edhe elektronike, një listë me rubrikë pyetjesh për auditorin, një listë sintetike bibliografie (të asaj ku janë mbështetur dhe të asaj që sugjerohet për studime të mëtejshme); një listë kazusesh dhe vendimesh unifikuere të Gjykatës së Lartë, sipas rastit të Gjykatës Kushtetuese dhe vendime të gjykatave ndërkombëtare të rëndësishme, për çështje si të GJEDNJ-së dhe të GJED-së, si dhe bazën ligjore që gjyqtarët dhe prokurorët duhet të kenë gjatë trajnimit. Në mënyrë të veçantë kërkohet lidhja e ligjit shqiptar me standardet ndërkombëtare, jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe GJED-së dhe aty ku ka përafrim të legjislacionit, edhe njohjen e ligjit të BE-së, kjo me qëllim rritjen e cilësisë së drejtësisë dhe përmbushjen e misionit strategjik që ka SHM-ja për të qenë pararendëse e zhvillimeve të shpejta që pritet të vijnë nga ridimensionimi i marrëdhënieve me Bashkimin Evropian.

I. II. c Realizimi i kalendarit të trajnimeve

Trajnimet e parashikuara për t'u zhvilluar gjatë periudhës shtator 2022 – korrik 2023, gjithsej 103 për vitin akademik 2022-2023, në pjesën më të madhe u zhvilluan në mjediset e Shkollës së Magjistraturës, ndërkohë që një pjesë e tyre, për shkak të pamundësive të ekspertëve për të qenë të pranishëm, apo për shkak të bashkëpunimeve të ndryshme me ekspertë të huaj, u zhvilluan online në platformën *Zoom* ose në formatin hibrid.

Partnerët ndërkombëtarë mbështetën disa prej aktiviteteve trajnuese të Shkollës. Numri më i madh i trajnimeve është realizuar nga vetë Shkolla e Magjistraturës edhe pse kërkesat për mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë kanë qenë të shumta. Shkolla është kujdesur në mënyrë aktive që mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë të bazohej në nevojat reale të SHM-së dhe projektet të mos mbivendoseshin me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, kjo mbështetje ka konsistuar, më së shumti, në dhënien e ekspertizës dhe në çështjet e organizimit. Të dhënat për këtë mbështetje dhe raportin me trajnimet e tjera të organizuara nga SHM-ja e gjeni në grafikët 1, 2 dhe 3, si më poshtë:




Numri i trajnimeve sipas muajve për vitin akademik 2022-2023

Nr.	Muajt	Trajnime SHM	Trajnime të mbështetura/të zhvilluara me donatorë	Trajnim Trajnerësh
1.	Shtator 2022	0	4	3
2.	Tetor 2022	0	3	0
3.	Nëntor 2022	10	1	1
4.	Dhjetor 2022	11	0	0
5.	Janar 2023	9	0	0
6.	Shkurt 2023	10	2	0
7.	Mars 2023	12	4	0
8.	Prill 2023	9	1	0
9.	Maj 2023	16	8	0
10.	Qershor 2023	15	5	0
11.	Korrik 2023	0	1	0

Shpërndarja mujore e aktiviteteve për vitin akademik 2022-2023

Raporti i trajnimeve të mbështetura nga donatorët me ato të organizuara vetëm nga SHM



Trajnimet e mbështetura nga donatorët/trajnimet të organizuara nga SHM-ja, 2022-2023

Në një vështrim krahasues me vitin akademik 2021-2022, vihet re një rritje e aktiviteteve trajnuese të mbuluara nga buxheti i Shkollës.

Temat e trajnimeve

Trajnimet e formimit vazhdues kanë si synim të jenë të specializuara dhe sa më pranë nevojave të sistemit të drejtësisë me qëllim forcimin e kapaciteteve të tij. Për këtë arsye, SHM-ja organizon trajnimet të orientuara në fusha të ndryshme të së drejtës dhe për grupe të caktuara subjektsh.

Kështu, SHM-ja ka organizuar trajnimet të posaçme, si për shembull:

- ***trajnimet për të drejtat e njeriut:*** Jurisprudenca vendase dhe ajo e GJEDNJ-së, konstatimet dhe interpretimet lidhur me kërkesat apo të drejtat themelore të pretenduara të cenuara nga të dënuarit në fazën e ekzekutimit të vendimit; e drejta e informimit, mbrojtja e të dhënave personale dhe rastet e kufizimeve të saj. Roli i komisionerit në zbatimin e ligjit dhe vlerësimin e zbatimit të këtyre kufizimeve. Analizë mbi zbatueshmërinë e ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe problematikat që diktuan nevojën për ndërhyrje në këtë ligj. Ndikimi i legjislacionit të ri të mbrojtjes së të dhënave personale në punën e gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median. Gjyqtari për median dhe roli i tij në informimin e medias dhe publikut për çështjet gjyqësore. Roli i gjyqtarit për median në forcimin e besimit të publikut te drejtësia. Rregullat bazë të vendosura nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), për komunikimin në fushën e drejtësisë. Komunikimi i gjyqësorit dhe i prokurorisë me mediat dhe publikun.
- ***trajnimet për temat që lidhen me korrupsionin dhe trajnimet për SPAK-un:*** Korrupsioni aktiv apo pasiv, ushtrimi i ndikimit të paligjshëm. Veçori të hetimeve proaktive në luftën kundër tyre në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar. Metodika dhe teknika të hetimit të tyre dhe krimeve financiare rrjedhur nga korrupsioni. Prova e vetme në procesin penal në rastet praktike, rëndësia e saj dhe hetimi efektiv i veprave penale që lidhen me veprat penale të korrupsionit dhe çfarë rrjedhin prej tij. Krimi ekonomik dhe financiar nën këtë

këndvështrim. Hetimi i tyre; prokurimi publik. Trajtimi i rasteve dhe hetimi efektiv i veprave penale që lidhen me fushën e prokurimeve publike, prishjen e barazisë në tender dhe me mospagimin e taksave dhe tatimeve. Pabarazia në tendera. Marrëveshjet në oferta në procedurat e prokurimit publik; pastrimi i parave dhe rikuperimi i aseteve.

- **trajtime për administratën gjyqësore dhe kancelarët:** Roli i Këshillit të Gjykatës në përmirësimin e performancës.
- **trajtime për “soft skills”, etikë, sjellje dhe komunikim:** Kodi i Etikës Gjyqësore në raport me Primet Themelore të Kombeve të Bashkuara, Rekomandimi CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave të KE-së për gjyqtarët në lidhje me pavarësinë, eficientë dhe përgjegjësitë, Kartën Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve dhe memorandumit shpjegues të saj të përgatitur nga KE. Rekomandimet e Kievit të OSBE-së për pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Juglindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore (2010); Vlerësimi etiko-profesional i magjistratëve. Sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në ushtrim të funksioneve të tyre zyrtare; sjellja e gjyqtarëve dhe prokurorëve jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare. Dallimi ndërmjet shkeljeve në kuadër të vlerësimit etiko-profesional nga shkeljet me karakter disiplinor. Etika gjyqësore. Parimet etike të detyrueshme për një gjyqtar sipas Kodit Etik të miratuar nga KLGJ-ja; etika e prokurorit. Parimet etike të detyrueshme për një prokuror, sipas "Standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së prokurorit", miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, datë 24.2.2022
- **trajtime të fokusuara për gjyqtarë:** Shkrimi dhe arsyetimi i vendimit gjyqësor, praktikat më të mira; kontratat administrative. Forma e tyre. Zgjatja në heshtje e kontratave administrative. Problemet e hasura në praktikën gjyqësore; rritja e eficientës në gjykimin civil: standardizimi i vendimeve në fazën e veprimeve paraprake. Sa cenon standardizimi i vendimeve (nëpërmjet krijimit të arsytimit tip) pavarësinë e gjyqtarit në gjykimin e çështjes? Diskutim mbi përvojën e dhomës civile të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për vendimet për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit. Cilat nga vendimet e marra gjatë fazës së veprimeve paraprake mund të standardizohen? Si mund të kodifikohet ky standardizim? Nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit të Gjykatës (pra këshilli miraton vendimet tip)? Apo duhet ndonjë akt nga KLGJ-ja?
- **trajtime të fokusuara për prokurorë:** Fillimi kryesisht i procedimit penal dhe pavarësia e prokurorit. Kuadri ligjor. Rastet dhe procedura që ndiqet për regjistrimin e procedimit kryesisht. Standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare; Viktima në procesin penal. Definicioni dhe legjitimiteti i saj në procesin penal. Paraqitja e padisë civile në procesin penal dhe rëndësia e saj. Kompetencat procedurale të viktimës. Ankimi, rekursi apo rishikimi i vendimit gjyqësor me iniciativën e viktimës. Hetimi i pavarur zhvilluar nga viktimat e veprës penale; Hierarkia e Prokurorisë dhe marrëdhënia procedurale ndërmjet prokurorit ndihmës dhe titullarit të prokurorisë; Hetimi proaktiv. Kuadri ligjor. Burimet e informacionit për hetimet kriminale të bazuara në inteligjencë dhe marrëdhëniet e prokurorit me shërbimet pas administrimit të informacionit prej tyre. Procedura që ndiqet për regjistrimin dhe ndjekur ecurinë e procedimeve proaktive. Standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare; Përgjegjësia e prokurorit për ushtrimin e detyrës në mënyrë të padrejtë dhe kundërshtim me ligjin. Standardet e pranuar rreth përgjegjësisë së tij etj.

Trajnimi i trajnerëve


Në vitin akademik 2022-2023 ka pasur gjithsej 4 (katër) aktivitete trajnimit trajnerësh, të cilat kanë qenë me shumë interes për pjesëmarrësit për shkak se janë fokusuar më tepër në zhvillimin e aftësive të tyre trajnuese dhe në metodologjinë e zhvillimit të trajnimit sipas të

cilës synohet të përçohen njohuri, aftësi dhe kompetenca të paracaktuara në kurikulën dhe objektivat e një aktiviteti trajnues.

I. II. d Ekspertiza

Aktiviteti trajnues dhe cilësia e tij janë të lidhura ngushtësisht me cilësinë e ekspertizës. Shkolla e Magjistraturës dhe Këshilli Drejtues kanë bërë shumë kujdes që të përzgjedhin në cilësinë e ekspertit, profesionistët më të mirë të fushave të caktuara, pjesa më e madhe e të cilëve kanë qenë magjistratë në detyrë, por edhe të pajisur me aftësi pedagogjike, apo që janë trajnuar sipas formatit të trajnimit të trajnerëve. Shkolla ka synuar që pjesa më e madhe e ekspertizës të jetë nga magjistratët në detyrë. Ka qenë gjithashtu shumë i çmuar dhe i kërkuar edhe kontributi i ekspertëve të fushave të ndryshme, pedagogë të nderuar, studiues të mirënjohur të së drejtës etj.

Grafiku nr. 3, si më poshtë, paraqet, në mënyrë të përmbledhur, llojin e ekspertizës në Shkollë dhe raportin mes tyre. Vihet re që magjistratët zënë vendin kryesor si ekspertë në Programin e Formimit Vazhdues.



Grafiku nr. 3 Ekspertët sipas kategorive, viti akademik 2022-2023

Një vëmendje dhe kujdes i veçantë i kushtohet edhe përzgjedhjes dhe caktimit të lehtësuesve dhe moderatorëve. Por, ndërsa moderatorët janë pjesë e panelit vetëm në aktivitete të një rëndësie të caktuar, apo që lidhen me veçanti të formatit të aktivitetit, dhe kanë qenë të rrallë në këtë vit, për lehtësuesit është treguar kujdes i posaçëm për shkak se lidhja e tyre me Shkollën synohet të jetë një lidhje afatgjatë, e specializuar në fushën e interesit të tyre dhe në atë çfarë Shkolla sheh si prioritare dhe shikohet si një investim që do t'i shërbejë, jo vetëm formimit vazhdues, por edhe atij fillestar, edhe kërkimeve e publikimeve.

I njëjti kujdes është treguar edhe në rastin e ekspertizës së huaj ku partnerëve ndërkombëtarë iu janë kërkuar të dhëna të sakta lidhur me përvojën profesionale të ekspertëve të propozuar prej tyre.

Ekspertët i nënshtrohen një vlerësimi të vazhdueshëm nga ana e Shkollës, vlerësim i cili analizon disa komponentë, si: seriozitetin e tyre në angazhimin e marrë përsipër; bashkëpunimin me panelin; ndërveprimin me auditorin; bashkëpunimin me sektorët e SHM-së në përmbushjen e detyrimeve lidhur me materialet që duhet të dorëzojnë, dokumentacionin personal, nënshkrimin e marrëveshjeve etj.; materialet e përgatitura; dhe vlerësimet që bëjnë pjesëmarrësit, në mënyrë anonime, në fund të aktivitetit trajnues.

Këtë vit akademik, Programi i Formimit Vazhdues ka hasur në vështirësi lidhur me pjesëmarrjen e ekspertëve/lehtësuesve për shkak të largimeve të shumta dhe të shpejta nga procesi i vetingut. Kjo e ka detyruar Shkollën të ndryshojë panelet disa herë dhe të ketë në dispozicion një numër më të ulët trajnerësh, një pjesë e të cilëve kanë qenë aktivë në Shkollë për vite me radhë.

Gjatë vitit akademik 2022- 2023, u shtua si pjesë e dosjes së aktivitetit trajnues Formulari Personal i Vlerësimit për ekspertët dhe lehtësuesit në panel. Ky formular pavarësisht se jo i detyrueshëm, ka për qëllim kryesor të marrë një feedback në lidhje me vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit trajnues nga një këndvështrim tjetër, por edhe një vlerësim në lidhje me anëtarët e tjerë të panelit dhe bashkëpunimin mes tyre. Secili ekspert apo lehtësues në trajnim vlerëson lidhur me: kohën e trajnimit nëse ishte e mjaftueshme dhe e llogaritur mirë mes panelistëve, nëse objektivat e trajnimit arritën të plotësoheshin, nëse pjesëmarrësit shfaqën interes dhe ishin bashkëpunues gjatë trajnimit, nëse pjesëmarrësit bënë sugjerime mbi çështjet e trajtuara, nëse ekspertët/lehtësuesit bashkëpanelistë adresuan pyetje dhe çështje të duhura dhe arritën të nxisnin interesin dhe diskutimin mes pjesëmarrësve, nëse mbështetja e ofruar nga Shkolla e Magjistraturës ishte e plotë dhe nëse trajnimi i përmbushi pritshmëritë dhe ju do të dëshironin të ishin sërish ekspertë apo lehtësues.

Ata gjithashtu vlerësojnë për ekspertët apo lehtësuesit bashkëpanelistë nëse ishin bashkëpunues, nëse ishin aktivë në përmbushjen e qëllimit të trajnimit, nëse ishin inkurajues të debateve në auditor dhe nëse sipas mendimit të tyre, bashkëpanelisti gëzon njohuri të gjera mbi temën.

I. II. e Pjesëmarrja e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të së drejtës

Shkolla ndjek procedurat që parashikon ligji për pjesëmarrje në programin e formimit vazhdues dhe gjithashtu, nëpërmjet platformës “Moodle” ka krijuar një mundësi të dytë dhe shumë efikase për regjistrimin në kurset e formimit vazhdues.

Bashkëpunimi me gjykatat dhe prokuroritë

Në bazë të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive, ashtu sikundër edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kanë detyrimin ligjor për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me Programin e Formimit Vazhdues. Dhënia e një mendimi të tillë, ndikon pozitivisht në gjithë procesin e organizimit të aktiviteteve trajnuese, duke shmangur zvarritjet, shpenzimet dhe duke rritur efektivitetin e këtyre trajnimeve. Kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e prokurorive, duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me problematikat e përditshme të drejtësisë (gjyqësor/prokurori), kanë potencialin të krijojnë një “urë lidhëse” me Shkollën e Magjistraturës, në funksion të rritjes së efektivitetit të formimit vazhdues të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Në këtë vështrim, Shkolla do të jetë në gjendje të vlerësojë drejt nevojat për

trajnim të sistemit në tërësi, duke u fokusuar në ato çështje, që paraqesin problematikat më komplekse në praktikën gjyqësore.

Edhe për vitin 2022-2023, kalendari vjetor së bashku me temat e propozuara i është dërguar çdo kryetari gjykate dhe drejtuesi prokurorie në nivel rrethi dhe apeli. Bashkë me të, çdo vit atyre iu rikujtohen edhe detyrimet që burojnë nga ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” lidhur me përfshirjen e tyre institucionale në procesin e përzgjedhjes së pjesëmarrësve për PFV-në.

Ky dokument është shoqëruar me një formular aplikimi për çdo gjyqtar e prokuror të gjykatave dhe prokurorive të rretheve dhe të apeleve. Edhe ky formular, me rikujtesën që të bëjnë kujdes të mos përzgjedhin të njëjtin trajnim dhe të mbajnë parasysh detyrimin e nenit 5 të ligjit nr. 96/2016 lidhur me ditët e trajnimit në vit dhe në 5 vjet.


Bashkëpunimi me gjykatat dhe prokuroritë ka qenë shumë i kënaqshëm, duke pasur parasysh edhe mungesat e mëdha në radhët e magistratëve që kanë pasur gjykatat dhe prokuroritë në gjithë vendin.

Roli i Sektorit të Formimit Vazhdues


Koordinimi dhe organizimi i çdo procesi në funksion të kalendarit dhe aktiviteteve trajnuese realizohet nga Sektori i Formimit Vazhdues, nën drejtimin e Pedagogut Përgjegjës për Formimin Vazhdues, këshillimin dhe orientimet e Këshilltarit Akademik të Shkollës, e më tej me vendimmarrjen e Drejtorit të Shkollës, Këshillit Pedagogjik dhe Këshillit Drejtues. Sektori i Formimit Vazhdues ka një ngarkesë të lartë pune edhe si rrjedhojë e hedhjes së të dhënave dhe informacioneve në sistemin “moodle”.

Disa të dhëna mbi pjesëmarrjen

- Fokusi kryesor i PFV-së janë magistratët në detyrë. Për këtë arsye, edhe numri më i lartë i pjesëmarrësve në trajnime janë nga radhët e magistratëve. Edhe këtë vit akademik, interesi dhe pjesëmarrja nga gjyqtarët ka qenë më e lartë sesa nga prokurorët. Sipas tyre, kjo lidhet edhe me ngarkesën e lartë të prokurorisë në këtë vit dhe me një lloj “varësie” që ata kanë nga gjykata për përcaktimin e datave të lira se kur ata mund të jenë edhe pjesë e aktiviteteve trajnuese. Grafiku në vijim bën një ndarje të subjekteve pjesëmarrëse në aktivitete sipas kategorive.



Pjesëmarrja sipas kategorive në aktivitetet për vitin 2022-2023



Raporti mes subjekteve pjesëmarrës dhe të pacertifikuar për vitin akademik 2022-2023

Gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, si dhe kategori të tjera, që morën pjesë në aktivitetet trajnuese të Programit të Formimit Vazhdues gjatë vitit akademik 2022-2023, në përfundim të aktiviteteve trajnuese janë regjistruar në databazën elektronike në pjesëmarrje sipas listëprezencave përkatëse të mbajtura për çdo ditë dhe sesion.

Komponenti i frekuentimit është ndjekur me prioritet nga sekretaria shkencore e Formimit Vazhdues, e cila ka mbajtur rekorde të sakta lidhur me këtë çështje, ku për çdo ditë të aktiviteteve trajnuese janë mbajtur dy listëprezencat: sesioni i paradites dhe sesioni i pasdites ku çdo pjesëmarrës në trajnim ka firmosur.

Përgjatë vitit akademik 2022-2023 vërejmë se, në përgjithësi, pjesëmarrësit kanë frekuentuar në mënyrë të rregullt aktivitetet trajnuese.


Problematika që është shfaqur më dukshëm në lidhje me Programin e Formimit Vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve është:

- pjesëmarrja/frekuentimi i gjyqtarëve/prokurorëve në aktivitetet trajnuese krahasuar me numrin e aplikimeve dhe ftesave për pjesëmarrje që i janë dërguar nga Shkolla.

Shkolla e Magjistraturës inkurajon në vazhdimësi pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në aktivitetet trajnuese, edhe nëpërmjet formave të drejtpërdrejta të komunikimit me ta.

Shkolla vlerëson se në këtë drejtim është shumë e rëndësishme të vendoset një “urë komunikimi” e vazhdueshme mes kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të prokurorive, si përfaqësues të këtyre institucioneve në marrëdhënie me të tretët dhe Shkollës së Magjistraturës. Ajo e ka realizuar këtë objektiv nëpërmjet vendosjes së pikave të kontaktit me çdo gjykatë e prokurori dhe me anë të një shërbimi me kosto sa më të ulët dhe të shpejtë, është vendosur komunikimi i çdo njoftimi lidhur me Formimin Vazhdues me anën e platformës “moodle” dhe postës elektronike. Përmes këtij komunikimi të vazhdueshëm, Shkolla mund të informohet në lidhje me pretendimet e gjyqtarëve dhe të prokurorëve për nivelin e trajnimeve, për çështjet që paraqesin më shumë interes për t’u trajtuar brenda një seance trajnimi, për probleme të praktikës gjyqësore me të cilat ata ndeshen çdo ditë, me qëllim përditësimin e Kalendarit të Formimit Vazhdues dhe pasurimin tij në të ardhmen.

Pjesëmarrja në Programin e Formimit Vazhdues është pjesë e rëndësishme e sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve e prokurorëve, përpos faktit që trajnimet ndikojnë në rritjen e performancës së tyre në ushtrimin e funksionit. Nga kjo pikëpamje, mbështetja e KLGJ-së dhe KLP-së në realizimin sa më efektiv të Programit të Formimit Vazhdues, është shumë e rëndësishme për Shkollën dhe është në interesin e vetë sistemit të drejtësisë.



Në grafikun më sipër vihet re se frekuentimi i sesioneve trajnuese për tema/kurse nga ana e gjyqtarëve/prokurorëve është më i ulët në krahasim me numrin e aplikimeve të bëra prej tyre për të marrë pjesë dhe ftesave për pjesëmarrje të dërguara nga Shkolla. Kjo ka shkaktuar vështirësi për Programin e Formimit Vazhdues, i cili, ka pasur një numër më të ulët pjesëmarrësish në trajnim se ai i planifikuar.

Numri i aplikuesve për çdo aktivitet mesatarisht shkon nga një minimum prej 25 (njëzet e pesë) deri në një maksimum prej 60 (gjashtëdhjetë) gjyqtarë/prokurorë, me përjashtim të


rasteve kur kërkesat janë më të ulëta apo më të larta. Megjithatë, ditën e aktivitetit, numri i pjesëmarrësve ka shkuar edhe nën një mesatare të pranuar deri më tani nga Shkolla, prej 15 (pesëmbëdhjetë) pjesëmarrësish, në një aktivitet.

Gjithashtu, konstatohet se ka gjyqtarë e prokurorë që nuk kanë aplikuar asnjëherë dhe nuk kanë marrë pjesë në asnjë sesion trajnues. Këta pa dyshim përbëjnë një grup të kufizuar, por ky fenomen duhet të konsiderohet seriozisht nga KLGJ-ja dhe KLP-ja. Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me KLGJ-në dhe KLP-në, do të vijojë të angazhohet për të siguruar një pjesëmarrje më të madhe në aktivitetet trajnuese nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Të dhëna më të detajuara për gjyqtarët dhe prokurorët më vete, jepen në tabelën dhe grafikun si vijon:

Ditët	Gjyqtarë	Prokurorë
0-4 ditë	48	70
Mbi 5 ditë	154	75

Ditët e pjesëmarrjes në aktivitetet trajnuese për çdo gjyqtar dhe prokuror



Ditët e trajnimit për kategoritë gjyqtar dhe prokuror për vitin akademik 2022-2023

Nga të dhënat e pasqyruara edhe në grafik vihet re se gjyqtarët kanë frekuentuar trajnimet në Shkollë më shumë se prokurorët. Megjithatë, në tërësi, numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë frekuentuar trajnimet ka qenë i kënaqshëm, duke pasur parasysh se ngarkesa e tyre në punë ka qenë shumë e lartë.

I. II. f Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe institucione të tjera të drejtësisë në vend

Bashkëpunimi me Këshillat, përveçse një detyrim që buron nga ligji, vlerësohet si një ndër elementet kyçe të suksesit të formimit vazhdues.

Aftësimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe kancelarëve ka ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e sistemit të drejtësisë, jep të dhëna të besueshme për vlerësimin profesional të tyre dhe jep mundësinë e një lidhje të qëndrueshme dhe kronologjike mes nevojave dhe pritshmërive të organeve qeverisëse të drejtësisë dhe përmbushjes së tyre nga ana e Shkollës së Magjistraturës.

Gjithashtu, bashkëpunimi me institucione të tjera të rëndësishme të drejtësisë në vend, si Prokuroria e Përgjithshme (PP), Gjykata e Lartë (GJL), Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD), Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (APSH), Ministria e Drejtësisë (MD) e të tjera, vlerësohet si shumë i rëndësishëm në çështje të ndryshme që lidhen me formimin vazhdues, duke nisur me analizën e nevojave, ku secila nga këto institucione mund të japë kontribut, e duke vijuar në ofrimin dhe nxitjen e ekspertizës, propozimin e temave në rastet e ndryshimeve të rëndësishme në legjislacion, e duke krijuar edhe mundësi bashkëpunimi për trajnimin e stafit jogjyqësor, por të rëndësishëm për të marrë pjesë në disa aktivitete të formimit vazhdues me qëllim përdorimin e standardeve në mënyrë të njëjtë e të harmonizuar.

Për këto arsye, Shkolla ka bashkëpunuar ngushtësisht me Këshillat, veçanërisht:

- duke përcjellë informacion dhe të dhëna të plota mbi hartimin e Programit Tematik dhe Kalendarit të Aktiviteteve Trajnuese për vitin akademik 2022-2023;
- duke reflektuar rekomandimet për trajnim që janë bërë nga Këshillat;
- duke përcjellë një informacion të plotë mbi ndjekjen dhe realizimin e të gjitha aktiviteteve trajnuese të parashikuara, listat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve pjesëmarrës në këto aktivitete trajnuese;
- duke përcjellë informacion të plotë mbi Programin e Formimit Fillestar dhe Vazhdues të ndihmësve e këshilltarëve ligjorë në gjykata dhe mbi Programin e Formimit Fillestar dhe Vazhdues të kancelarëve në gjykata dhe prokurori etj.

Shkolla ndërmori edhe një rol aktiv në realizimin e disa takimeve me KLGJ-në, KLP-në, PP-në dhe MD-në me qëllim forcimin e bashkëpunimit me Shkollën dhe dhënien e një kontributi të vazhdueshëm e periodik nga ana e këtyre organeve.

I.III BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

I.III. a Drejtimit e bashkëpunimit

Bashkëpunimi me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë është një ndër elementet më të çmuara që ka Shkolla e Magjistraturës, me ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e performancës së Shkollës në fushat kryesore të veprimtarisë së saj. Sektori i Integritimit Evropian, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë është zyra që ndihmon këtë bashkëpunim nëpërmjet monitorimit, ndjekjes dhe vlerësimit të qëndrueshmërisë dhe ndikimit të projekteve dhe realizimit të marrëdhënieve me partnerët ndërkombëtarë të Shkollës.

Gjatë vitit akademik 2022-2023 bashkëpunimet kanë qenë të shumta, si për nga numri, edhe për nga rëndësia që kanë pasur për Shkollën. Kështu, Shkolla ka bashkëpunuar ngushtësisht në tre drejtimit kryesore të saj: në programin e formimit fillestar, në programin e formimit vazhdues dhe publikimeve dhe kërkimit shkencor.

Si rezultat i realizimit të marrëdhënieve me partnerët ndërkombëtarë, Shkolla e Magjistraturës ka lidhur apo rinovuar marrëveshjet e bashkëpunimit me OSBE-në, Akademinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës, Akademinë e Drejtësisë së Turqisë, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Akademinë e Drejtësisë së Armenisë, Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi” si dhe me Akademinë e Sigurisë.

I.III. b Aktivitete të rëndësishme gjatë vitit akademik 2022-2023

- **Konferenca “Drejtësia penale në veprim”. 25-vjetori i Themelimit të Shkollës së Magjistraturës**

Me rastin e 25-vjetorit të veprimtarisë akademike të saj, si dhe me rastin e fillimit të vitit të ri akademik 2022-2023, në 3 tetor 2022, në Tirana International Hotel, Shkolla e Magjistraturës organizoi aktivitetin kremtues të këtij përvjetori dhe Konferencën Shkencore “Drejtësia penale në veprim”.

Ky aktivitet kremtoi 25 vjet veprimtari të Shkollës së Magjistraturës, duke evidentuar rrugëtimin që ka bërë institucioni që nga fillimet e tij në kualifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm, e deri në konsolidimin dhe shndërrimin e tij në një institucion me status kushtetues, shumë i rëndësishëm në realizimin e detyrave të saj ligjore.

Eventin e përshëndetën personalitete të larta dhe drejtues të institucioneve kryesore të vendit, si Presidenti i Republikës, Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Drejtësisë, si dhe përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në vijim, eventin vijoi me konferencën shkencore “Drejtësia penale në veprim”, ku u mbajtën kumtesa të ndryshme nga ekspertë të fushës në lidhje me tematika përfshirëse në Drejtësinë Penale në vend.



- **Bashkëpunimi me Prezencën e OSBE-së**

Bashkëpunimi me OSBE-në ka vijuar edhe gjatë periudhës 2022-2023 në prezantimin e Projektit “Për forcimin e kapaciteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Akademisë së Sigurisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore”. Projekti financohet nga qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Norvegjisë dhe Italisë dhe synon të mbështesë institucionet shqiptare që të ofrojnë programe trajnimi të rregullta, të specializuara dhe të qëndrueshme për njësitë ligjzbatuese përkatëse sipas sektorëve, si edhe për gjyqtarët dhe prokurorët, duke mundësuar identifikimin dhe mbështetjen e duhur për viktimat, si edhe zbatimin e njëjësuar të ligjit në varësi të nivelit të rëndesës së veprës penale. Për këtë qëllim, u nënshkrua dhe Marrëveshja e Bashkëpunimit për zbatimin e komponentëve përbërës të projektit.

Në kuadër të këtij projekti, u organizua një vizitë studimore pranë Shkollës Italiane të Magjistraturës në Romë, në datat 2-3 maj 2023. Vizita synoi njohjen e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si edhe të Shkollës së Magjistraturës me kuadrin ligjor dhe praktikën gjyqësore italiane në lidhje me provat në gjykimet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe “kontrabandën” e migrantëve, kryerja e këtyre krimeve në kuadrin e krimit të organizuar si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Gjyqtarë dhe pedagogë të Shkollës së Magjistraturës së Shqipërisë morën pjesë në këtë vizitë në kuadër të një projekti të mbështetur nga qeveritë e Shteteve të Bashkuara, Norvegjisë dhe Italisë ku përfshihen një sërë veprimtarish që Prezenca e OSBE-së ka ndërmarrë me këtë institucion për të mbështetur fuqizimin e kapaciteteve trajnuese të Shkollës në masat ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.

Njëkohësisht, Prezenca e OSBE-së, në bashkëpunim me Shkollën realizoi përgatitjen e programit mësimor të lëndës së re, atë të të Drejtës së Mjedisit, e cila u përfshi në programin mësimor të vitit akademik 2023-2024.

Kursi i ri mbi legjislacionin mjedisor do të ndihmojë në ngritjen e një brezi magjistratësh të përgatitur dhe me kapacitetet e duhura për të trajtuar dhe gjykuar çështjet mjedisore, e cila do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e efektivitetit të përgjigjes së institucioneve ligjzbatuese ndaj kundërvajtjeve dhe krimeve mjedisore.



Rrjeti Evropian për Trajnimin Gjyqësor - EJTN

Edhe për këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi me EJTN-në me pjesëmarrjen e magjistratëve në detyrë në programet e shkëmbimit të rrjetit. Njëkohësisht është realizuar pjesëmarrja e skuadrës së shkollës në konkursin THEMIS për këtë vit, në 5-9 qershor 2023, si dhe përfaqësimi i Shkollës në konferencat e ndryshme vjetore të këtij rrjeti të trajnimit gjyqësor.

- **Konkursi Ndërkombëtar THEMIS, 5-9 qershor 2023**

Në kuadër të bashkëpunimit me Rrjetin Gjyqësor Evropian të Trajnimeve, nga data 5-9 qershor 2023, Shkolla e Magjistraturës, si çdo vit, mori pjesë në konkursin ndërkombëtar e-THEMIS në gjysmë finalen B, e Drejta Familjare Evropiane dhe e BE-së. Konkursi u zhvillua në qytetin e Napolit, Itali. Në këtë aktivitet Shkolla u përfaqësua nga Erollda Tarelli, Eda Gjovari dhe Boiken Bendo, të tre kandidatë për magjistratë në vitin e dytë të studimeve, nën mentorimin e pedagoges prof. dr. Mariana Semini.



“Të vendosësh për një të mitur si prind – detyrimi për ushqim dhe sfidat e gjykatës” ishte tema me të cilën u prezantua Shkolla e Magjistraturës. Garantimi i të drejtave të të miturve si dhe i interesit më të lartë të tyre është një përgjegjësi ligjore jo vetëm e shtetit, por e të gjithë shoqërisë.

- **Konferenca vjetore e Rrjetit Evropian për Trajnimet Gjyqësore - EJTN**

Me ftesë të Rrjetit Evropian për Trajnimet Gjyqësore, Shkolla e Magjistraturës u ftua të përfaqësohet në këtë aktivitet vjetor të rëndësishëm, që u zhvillua në datat 15-16 qershor 2023. Shkolla u përfaqësua në këtë konferencë me z. Sokol Berberi, pedagog përgjegjës për

Programin e Formimit Fillestar. Aktiviteti u organizua dhe u zhvillua në bashkëpunim me Akademinë e Trajnimit Gjqësor të Suedisë dhe Shërbimit të Prokurorisë së Suedisë. Gjatë aktivitetit u prezantua dhe miratua raporti vjetor i EJTN-së, si dhe u bë një prezantim i sistemit gjyqësor dhe atij të trajnimeve në Suedi. Njëkohësisht, u përcaktua takimi i radhës që zhvillohet nën Presidencën Belge të Këshillit të Bashkimit Evropian.



- **Bashkëpunimi me Rrjetin HELP**

Ka vijuar bashkëpunimi edhe me rrjetin HELP të Këshillit të Evropës ku gjatë vitit në fjalë janë realizuar dy aktivitete trajnuese nëpërmjet platformës së rrjetit për kandidatët për magistratë në lidhje me temat e Etikës Profesionale dhe Mbrojtja e të Dhënave dhe Jetës Private. Kandidatët u trajnuan për një periudhë prej 6 javësh në lidhje me çështje dhe nën-çështje të rëndësishme të fushës specifike të etikës profesionale dhe mbrojtjes së të dhënave dhe jetës private.

- **Projekti AICS-CSM “Mbështetje për Shkollën e Magjistraturës në kuadër të reformës kushtetuese”**

Për periudhën objekt i raportit, në kuadër të këtij projekti, të sapo përfunduar, realizuar në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Magjistraturës së Italisë, u realizua pjesëmarrja e ekspertëve italianë në implementimin e disa aktiviteteve trajnuese, si në 22 nëntor 2022 për “Tentativën”, 1-2 dhjetor 2022 për “Viktimitën në procesin penal”, 15 dhjetor 2022 “Pronësia dhe mbrojtja e saj”, 4-5 maj 2023 “Kontrolli i banesës”, 8-9 maj 2023 “Prokurimi publik” si dhe 15-16 maj “Përgjimi, infiltrimi, blerja e kontrolluar si mjete të kërkimit të provës në mbështetje të hetimeve proaktive dhe komplekse”.



Njëkohësisht si mbështetje për Konkursin e Pranimit në Shkollë 2022-2023, projekti ofroi mbështetjen e tij për monitorimin e konkursit, si dhe mundësoi publikimin e kopjeve të nevojshme të legjislacionit shqiptar të të drejtës civile dhe atij të të drejtës penale për nevoja të konkursit.

- **Bashkëpunimi me Institutin Evropian të Administratës Publike - EIPA**

Në kuadër të Programit të Asistencës Teknike të Luksemburgut për Shqipërinë, në bashkëpunim me EIPA janë zhvilluar disa aktivitete trajnuese:

1. Një seminar trajnues në datat 5 dhe 6 tetor 2022 me tematikë “Organizimi gjyqësor i Bashkimit Evropian: Gjykata e Drejtësisë së BE-së dhe Roli i Gjykatave Kombëtare”, i ofruar për kandidatët për magjistratë. Seminari përshkroi rolet dhe kompetencat e GJED-së dhe paditë që mund të ngrihen përpara saj. Krahas kësaj, seminari ofroi në detaje detyrat dhe prerogativat që i korrespondojnë gjykatave kombëtare në zbatimin e ligjshmërisë së BE-së. Rrjedhimisht, pjesëmarrësit mësuan alokimin e kompetencave juridiksionale ndërmjet gjykatave kombëtare dhe GJED-së, dhe kuptuan se cilat janë ato raste kur janë kompetente vetëm gjykatat kombëtare.

Seminari udhëhoqi gjithashtu pjesëmarrësit nëpër sistemin juridik të BE-së duke paraqitur instrumente të ndryshme ligjore të BE-së dhe duke shpjeguar fuqinë e tyre ligjore respektive dhe pasojat e tyre praktike gjatë aplikimit dhe interpretimit nga gjyqtarët kombëtarë, duke bërë komente gjithashtu për parimet ligjore të BE-së që kanë nevojë të merren në konsideratë nga këta magjistratë në gjykimet e tyre: parimi i prevalencës, efektit të drejtpërdrejtë dhe përgjegjësisë shtetërore.

2. Në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me EIPA organizoi në datat **13-14 korrik** aktivitetin trajnues me temë: **“Praktika gjyqësore për prokurimin publik”**. Paneli në këtë aktivitet trajnues përbëhej nga: prof. Piotr Bogdanowicz – Profesor i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Varshavës, dr. Reida Kashta - Drejtor i Përgjithshëm, Autoriteti i Prokurimit Publik, Juan Diego Ramirez Cardenas Diaz Lektor i Nivelit të Lartë, Gracia Vara Arribas Expert, Lektor i Nivelit të Lartë.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti trajnues ishte prezantimi me parimet dhe procedurat e politikës evropiane të prokurimit publik, duke u fokusuar në Direktivat e Prokurimit Publik dhe praktikën gjyqësore përkatëse. Një nga pikat kryesore të diskutimit ishte Direktiva e Prokurimit Publik 2014/24/BE dhe Direktiva e Shërbimeve Komunale 2014/25/BE.



Gjatë aktivitetit u morën njohuri për zbatimin e praktikave profesionale të prokurimit dhe u trajtuan tema të ndryshme, si: hyrje e përgjithshme në rregullat dhe praktikat e Prokurimit Publik Evropian; praktika gjyqësore në Shqipëri për Prokurimin Publik, një hartëzim i gjendjes aktuale; praktika gjyqësore referuese e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian për Prokurimin; praktika gjyqësore referuese e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian për Prokurimin; praktika gjyqësore e fundit e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian për prokurimin – fokusi i posaçëm në çështjet e mashtrimit dhe korrupsionit etj.

3. Seminar online “Liria e shprehjes dhe mbrojtja e personalitetit”.

Qëllimi kryesor i këtij kursi *online* ishte prezantimi i çështjeve kryesore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në fushën e lirisë së shprehjes duke u përqendruar kryesisht në mënyrën se si çështja përkatëse e dy trupave gjyqësore mbinacionale ka formësuar rendet ligjore kombëtare.

• **Bashkëpunimi me Programin Fulbright të Shteteve të Bashkuara të Amerikës**

Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mundësuar nëpërmjet Programit të Shkëmbimeve Akademike Fulbright, Shkolla pati mbështetjen e një prokurori amerikan, z. Jay Shapiro, me ekspertizë teknike dhe profesionale për një periudhë prej katër muajsh gjatë vitit 2023.

Prokurori Shapiro u angazhua në të dy drejtimet kryesore të punës në Shkollë, në programin e formimit fillestar dhe atë të vazhduar. Në programin e formimit fillestar, angazhimi u realizua në pjesëmarrjen në forcimin e kapaciteteve të stafit pedagogjik në rishikimin dhe zhvillimin e lëndëve mësimore. Prokurori Shapiro u angazhua në rishikimin e lëndës së etikës profesionale si dhe në hartimin e dy lëndëve të reja, si e drejta penale evropiane dhe kursin e posaçëm për kandidatët për prokurorë në Shkollë.

Njëkohësisht, ai mori pjesë aktive në mësimdhënie në ofrimin e aftësive dhe njohurive për kandidatët për magistratë të vitit të parë të studimeve në lëndë të caktuara si e drejtë penale, e drejtë procedurale penale, shkrimi dhe arsyetimi ligjor.

Përsa i takon programin të formimit vazhduar, z. Shapiro u përfshi si ekspert në seminare të ndryshme për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë në tematika, si: interceptimi, infiltrimi, blerja e kontrolluar, krimi kibernetik dhe përgjegjësia penale e personave juridikë.



- **Program Ndërkombëtar Trajnimi për të Drejtat e Njeriut me Akademinë e Drejtësisë së Turqisë**

Shkolla e Magjistraturës mori pjesë në aktivitetin “International Training Program on Contemporary issues in Human Rights Law”, në datat 23-26 maj 2023. Në këtë aktivitet të organizuar nga Akademia e Drejtësisë së Turqisë dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) morën pjesë 9 shtete: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina dhe Republika Srpska, Bullgaria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia, Rumania dhe Turqia. Shqipëria u përfaqësua nga kandidatët për gjyqtar znj. Olta Cenaj, z. Elvis Sulejmani dhe z. Romeo Merruko, si dhe pedagogët dr. Amarildo Laçi dhe dr. Erjon Muharremaj.

Në aktivitet u analizuan zhvillimet më të fundit në fushën e të drejtave të njeriut dhe jurisprudenca përkatëse e GJEDNJ-së. Në ditën e fundit të aktivitetit ekipet përfaqësuese të shkollave të magjistraturës morën pjesë në konkursin mbi jurisprudencën e GJEDNJ-së. Pas prezantimeve të ekipeve pjesëmarrëse, Shkolla e Magjistraturës së Shqipërisë u shpall fituese për prezantimin individual të znj. Olta Cenaj, ndërsa Shkolla e Magjistraturës e Maqedonisë së Veriut u shpall fituese për prezantimin si ekip.



Në përfundim të aktivitetit, pedagogët e Shkollës së Magjistraturës zhvilluan një takim me drejtuesit e Akademisë së Drejtësisë së Turqisë, Presidentin z. Muhittin Özdemir dhe Drejtuesin e Departamentit z. Hasan Kadir Yilmaztekin. Në takim u diskutua mundësia e nënshkrimit të një memorandumi bashkëpunimi dypalësh, si dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, për forcimin e kapaciteteve reciproke dhe shkëmbimin e përvojave më të mira.

- **Aktivitet trajnues me mbështetjen e fondacionit gjerman IRZ**

Në kuadër të bashkëpunimit me fondacionin gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar IRZ, në datën 18-19 maj 2023, u realizua zhvillimi i seminarit të trajnimit për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë me tematikë: **“Krimet kompjuterike”**.

Krimi kibernetik. Aktet me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike. Provat elektronike. Aktiviteti u zhvillua në mjediset e Shkollës së Magjistraturës në Tiranë, ku të ftuar nga Shkolla morën pjesë z. Jan Schmieder, Menaxher i projektit dhe z. Frank-Michael Laue, Kryeprokuror i prokurorisë së landit gjerman Gottingen. Ekspertë të shkollës në aktivitet ishin z. Edmond Koloshi dhe znj. Denisa Asko.

Aktiviteti u përshëndet nga ekspertët dhe përfaqësuesit e fondacionit gjerman. Njëkohësisht, aktiviteti u përqendrua në trajtimin e tematikave, si krimi kibernetik dhe shoqëria e informacionit, Konventa e Budapestit, organizatat ndërkombëtare për krimin kibernetik si dhe penalizmi i akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike. Eksperti gjerman trajtoi tematika, si “Mënyra e veprimit të organeve gjermane

të ndjekjes penale në luftën kundër ngacmimeve në Internet duke marrë si shembull Zyrën Qendrore për Luftën kundër Kriminalitetit të Urrejtjes në Internet”, apo “Prezantimi i normave ligjore lëndore të zbatueshme dhe ndryshimet ligjore për bërjen më të efektshme të luftës nëpërmjet së drejtës penale kundër kriminalitetit të urrejtjes”.



Ky aktivitet është pjesë e një serie aktivitetesh ku angazhohen si ekspertë magjistratë gjermanë në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes që merr Shkolla e Magjistraturës nga fondacioni gjerman IRZ.

- **Aktivite të përbashkëta me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës**

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës, në datën 24 tetor 2022, Shkolla e Magjistraturës dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës organizuan dhe zhvilluan një aktivitet trajnues të përbashkët me tematikë **“Arsyetimi dhe shkrimi i vendimeve gjyqësore në Shqipëri dhe Kosovë: vështrim krahasues lidhur me standardet dhe praktikën në vendet respektive”**.

Aktiviteti u zhvillua në mjediset e Shkollës së Magjistraturës në Tiranë, ku të ftuar nga Shkolla morën pjesë Drejtori i Akademisë së Drejtësisë të Kosovës, z. Enver Fejzullahu dhe gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të ndryshme të gjyqësorit nga Republika e Kosovës, si nga gjykatat themelore, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë e Kosovës. Nga Shkolla e Magjistraturës, aktiviteti u përshëndet nga Drejtori i Shkollës, z. Arben Rakipi. Gjithashtu, pjesë e këtij aktiviteti ishte edhe pedagogu përgjegjës i programit të formimit fillestar, z. Sokol Berberi.

Aktiviteti u përqendrua në detaje të struktura dhe argumenti i vendimeve gjyqësore në Shqipëri, i ndjekur nga shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në Republikën e Kosovës, ku u parashtruan tradita dhe praktika aktuale e shkrimit të vendimeve në të dy vendet tona, si dhe u diskutuan gjerësisht standardet dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Secila tematikë u shoqërua me diskutime dhe debate përsa i takon praktikave gjyqësore të vendeve dhe problemeve të hasura.

Aktiviteti njëditor i trajnimit shënoi fillimin e realizimit të një sërë aktivitetesh trajnuese, të cilët fokusohen në formimin e vazhduar profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të dy vendeve për tematika me interes të përbashkët.



Krahas aktivitetit të sipërpërmendur, në datën 20 qershor 2023, me ftesë të Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, z. Arben Rakipi dhe një grup gjyqtarësh të Gjykatës Administrative të shkallës së parë, morën pjesë në një aktivitet trajnues të përbashkët të gjyqtarëve Kosovë & Shqipëri me tematikë **“Praktika gjyqësore në çështjet administrative: vështrim krahasues lidhur me standardet dhe praktikën në vendet respektive”**.

Aktiviteti u përqendrua në detaje të praktika gjyqësore në çështjet administrative në Kosovë, ndjekur nga praktika gjyqësore në çështjet administrative në Shqipëri. Në të dy trajtesat u parashtruan tradita dhe praktika aktuale e trajtesave në të dy vendet tona. Secila tematikë u shoqërua me diskutime dhe debate për sa i takon praktikave gjyqësore të vendeve dhe problemeve të hasura.



- **Bashkëpunimi me Akademinë e Drejtësisë së Armenisë**

Me ftesë të Rektorit të Akademisë së Drejtësisë së Armenisë, një delegacion i Shkollës së Magjistraturës, kryesuar nga Drejtori, z. Arben Rakipi, zhvilloi një vizitë studimore në akademinë e drejtësisë së Armenisë në 25-26 maj 2023 me synim vendosjen e marrëdhënieve

zyrtare dhe nënshkrimin e një memorandumi me fokus rritjen e bashkëpunimit midis të dy institucioneve.

Vizita kishte për qëllim njohjen me veçoritë e proceseve arsimore, arritjet në fusha të ndryshme të veprimtarisë së dy institucioneve, diskutimin për çështjet aktuale të praktikës ligjzbatuese, zhvillimin e programeve të përbashkëta arsimore dhe shkencore, në veçanti, organizimin e programeve të përbashkëta kërkimore, të cilat do të ndihmojnë në vendosjen e marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet stafit shkencor dhe pedagogjik të institucioneve tona dhe në shkëmbimin e praktikave më të mira.

Gjatë qëndrimit në Akademi, në 25-26 maj 2023, delegacioni shqiptar realizoi takime me Rektorin e Akademisë, z. S. Arakelyan dhe përfaqësues të tjerë të saj, si dhe mbajti një leksion informues për një klasë studentësh të akademisë, gjatë të cilës pjesëmarrësit u njohën me Shkollën e Magjistraturës dhe veprimtarinë e saj. Njëkohësisht, në një ceremoni të veçantë u realizua edhe nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve homologe.



- **Bashkëpunimi me Akademinë e Drejtësisë së Turqisë**

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe me ftesë të Akademisë së Drejtësisë së Turqisë, një grup magjistratësh në detyrë dhe përfaqësuesish të Shkollës së Magjistraturës morën pjesë në Programin Ndërkombëtar të Trajnimit “Praktikat e të Drejtës së Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtës Tregtare” të organizuar nga Akademia e Drejtësisë së Turqisë. Në këtë aktivitet merrnin pjesë përfaqësues dhe magjistratë të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë aktivitetit trajnues u trajtuan tematika të ndryshme të këtyre fushave, si parimet themelore të së drejtës së pronësisë intelektuale në Bashkimin Evropian, procedurat specifike të gjykatave të specializuara të kësaj fushe, raste studimore për të drejtën e autorit si dhe të së drejtës së pronësisë industriale. Njëkohësisht u trajtuan edhe procedurat e

veçanta në gjykatat tregtare, e drejta e shoqërive tregtare shoqëruar me raste praktike për shitjen e mallrave dhe të drejtën e sigurimeve. Aktiviteti u mbyll me një program të shkurtër kulturor dhe social.



- **Bashkëpunimi me Ambasadën e Francës**

Në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën e Republikës së Francës u zhvillua në Shkollë një aktivitet trajnues me tematikë programin e identifikimit balistik EvoFinder. Aktiviteti u organizua për kandidatët për magjistratë të vitit të dytë të studimeve në Shkollë.

Në aktivitetin trajnues mbajtën ligjëratat e tyre ekspertë francezë, si Kolonel Lejtnant Pascal SEURRE, këshilltar për armët e kalibrit të lehtë dhe z. Nicolas Chareyre, gjyqtar hetues pranë Gjykatës së Lionit, Francë. Njëkohësisht, në aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues të tjerë të Ambasadës së Francës në Shqipëri, si z. Augustin Andres, i ngarkuar me çështje të sigurisë.



Gjatë aktivitetit u trajtuan tematika të ndryshme të lidhura me programin e identifikimit balistik me interes për kandidatët për magjistratë, si dhe u trajtuan raste praktike të ndryshme për konkretizimin e njohurive të prezantuara.

- **Përmbyllja e projektit me Qendrën e Trajnimit Gjyqësor të Holandës**

Në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, në kuadër të javës holandeze, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi më 14 qershor 2023, eventin përmbyllës të projektit të bashkëpunimit të realizuar me qendrën e projektit “Mbështetja e Shkollës së

Magjistraturës për zhvillimin dhe zbatimin e programit të formimit fillestar dhe të vazhdueshëm”.

Projekti u financua nga qeveria e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta dhe ofroi mbështetje për Shkollën në drejtim të reformimit të programit të formimit fillestar në të gjitha komponentët e tij, duke filluar nga rishikimi i lëndëve të vitit të parë dhe vitit të dytë, si dhe ofroi mbështetje për programin e mentorimit, si një program shumë i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve profesionale të kandidatëve për magjistratë.

Eventi përmbyllës u përshëndet nga Drejtori i Shkollës, z. Arben Rakipi, pasuar nga Ambasadori i Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, z. Renoit Vos, si dhe ekspertë të Qendrës së Trajnimit Gjyqësor të Holandës, pedagogë të Shkollës dhe bashkëpunëtorë të tjerë.



- **Ceremonia e Diplomimit të brezit të magjistratëve 2020-2023**

Me rastin e përfundimit të programit 3-vjeçar të Formimit Fillestar të edukimit dhe formimit profesional të brezit të magjistratëve 2020-2023, Shkolla e Magjistraturës organizoi ceremoninë e diplomimit të tyre. Ceremonia u zhvillua në mjediset e amfiteatrit në godinën “Poli i Drejtësisë” me diplomimin e 40 gjyqtarëve dhe 26 prokurorëve.

Aktiviteti u përshëndet nga Drejtori i Shkollës dhe drejtues të institucioneve të ndryshme të drejtësisë si dhe përfaqësues të partnerëve kryesorë ndërkombëtarë të Shkollës. Eventu festoi këtë ngjarje të rëndësishme, duke evidentuar rrugën që magjistratët kaluan, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre. Të gjithë folësit theksuan rëndësinë që magjistratët e ardhshëm duhet t’i kushtojnë funksionit, rolit dhe detyrës së tyre në dhënien e drejtësisë dhe sigurimin e besimit të publikut të drejtësisë.

Në këtë mënyrë, Shkolla vijon të japë kontributin e saj cilësor në sistemin e drejtësisë në procesin e edukimit dhe formimit të magjistratëve, me gjithë vështirësitë dhe sfidat që hasen në përmbushjen e detyrës ligjore.



- **Bashkëpunimi me Delegacionin e Bashkimit Evropian - Misioni i ekspertëve Taiex**

Pas takimeve konsultative me përfaqësues të Zyrës së Delegacionit të Bashkimit Evropian në lidhje me procesin e rekrutimit në Shkollën e Magjistraturës u realizua një seminar konsultativ në 1-2 mars 2023 në lidhje me metodologjinë dhe parimet për hartimin e një provimi pranimi për gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët/ndihmësit ligjorë bazuar në parimet dhe modelet më të mira të BE-së dhe në modelet e akademive gjyqësore në të gjithë Evropën.

Qëllimi i seminarit ishte t'u ofronte përfituesve këshilla dhe trajnime praktike mbi mjetet dhe metodologjitë që mund të përdoren për të rishikuar provimin e pranimit në mënyrë që ai të ngjajë me modelet më të mira të zbatueshme të BE-së, por gjithashtu të mundësojë një provim të orientuar drejt aftësive. Në të njëjtën kohë, seminari synoi krijimin e një mjedisi shkëmbimi dhe debati të sinqertë mes stafit akademik dhe ekspertëve të BE-së, në bazë të dy modeleve të provimeve të aplikuara nga Shkolla në vitet e mëparshme.



- **Fushata e Ndërgjegjësimit dhe e Komunikimit**

Shkolla e Magjistraturës, përgjatë periudhës janar-mars 2023 zhvilloi fushatën e ndërgjegjësimit, ku u njoftuan zyrtarisht institucionet e sistemit gjyqësor, institucionet e qeverisjes vendore, institucionet akademike etj. Nëpërmjet kësaj fushate, SHM synoi rritjen e ndërgjegjësimit të aplikantëve të mundshëm duke dhënë orientime të rëndësishme për të gjithë të interesuarit, që aspirojnë për të marrë pjesë në provimin e pranimit. Më konkretisht, për procesin e rekrutimit të këtij viti, shkolla organizoi shtatë takime ndërgjegjësuese në rrethet kryesore të vendit, si në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë. Pjesëmarrësit e ftuar në këto takime ishin juristë, avokatë, noterë, punonjës të administratave të gjykatave dhe prokurorive të rretheve të ndryshme gjyqësore, si dhe nëpunës të profesioneve të lira të përfshira në sistemin juridik në vend.

Gjatë takimeve të zhvilluara në të gjitha qytetet e vendit u fol gjerësisht për historikun e Shkollës ku u evidentua përvoja dhe sfidat e kaluara gjatë periudhës 25-vjeçare të saj në

përgatitjen e magjistratëve; u ofrua një panoramë e karrierës në sistemin e drejtësisë me interes për pjesëmarrësit; u trajtuan kandidaturat ndër vite dhe gjendja e sistemit gjyqësor, duke e vendosur theksin te situata aktuale e favorshme për sa i takon kuotave për të gjithë aspirantët për të provuar konkurrimin me synimin për futjen në Shkollë. Njëkohësisht u trajtuan edhe trajtimi financiar i kandidatëve për magjistratë që përbën një garanci më shumë për seriozitetin e angazhimit të shtetit për kandidatët aspirantë.



Pedagogët përfaqësues të shkollës ndër takime shpjeguan përgatitjen këmbëngulëse që duhet ndërmarrë për të pasur një konkurrim fitues në provimin e pranimit si dhe angazhimin serioz që duhet pasur gjatë zhvillimit të 3 viteve të shkollës pas fitimit të konkursit. Krahas kësaj, është shpjeguar niveli shumë i lartë profesional i stafit pedagogjik të Shkollës, i cili përbën një motiv më shumë për aplikantët, të cilët nëpërmjet kryerjes së programit mësimor të formimit fillestar në shkollë, i sigurojnë vetes një nivel të lartë profesional nëpërmjet mësimdhënies nga ky staf pedagogjik i Shkollës.



U dhanë shpjegime të detajuara në lidhje me programin e pyetjeve të të dy fazave të konkursit të pranimit, qoftë ai skan tron por edhe testi profesional duke u ndalur në lëndët përbërëse përkatëse dhe trajtimin e pyetjeve të tyre. Për testin e skan tronit u shpjegua të bëhej kujdes në lidhje me fushat e gjuhës shqipe, etikës, lëndëve me karakter social, krahas atyre me karakter profesional në mënyrë që të sigurohej kalimi i pragut për në testin profesional. Për sa i takon testit profesional, u shpjegua në takime përbërja e lëndëve të testit bashkë me rastet praktike.

Gjatë gjithë shpjegimeve për të dy fazat e konkursit u dhanë këshilla praktike dhe strategji të ndryshme për kryerjen me sukses të provimit, si p.sh. menaxhimi i kohës, menaxhimi i pyetjeve/përgjigjeve sipas vështirësisë së tyre etj. Në tërësi u vu theksi te reformimi i programit të pyetjeve që bën çdo vit shkolla me qëllim thithjen e kandidatëve më të përshtatshëm për në pozicionin e magjistratit.

Në takime ishin të ftuar edhe kandidatët për magjistratë që aktualisht janë duke ndjekur studimet në Shkollë, të cilët ndanë përvojën e tyre personale me pjesëmarrësit. Nga ata u shpjegua, angazhimi dhe këmbëngulja që kërkohet për realizimin e një konkurrimi të suksesshëm për t'u futur në Shkollë. Në të njëjtën kohë, kandidatët shpjeguan paanësinë, objektivitetin dhe seriozitetin e të gjithë procesit që garanton Shkolla e Magjistraturës, duke filluar që nga procesi i regjistrimit, përgatitja e të dy fazave të provimit dhe vlerësimi i anonimizuar i përgjigjeve të dhëna nga aplikantët, qoftë në kalimin e fazës së parë të skan trinit, ashtu edhe në vlerësimin e anonimizuar të përgjigjeve të testit profesional nga komisioni i vlerësimit.



Takimet u përmyllën me seancat e pyetje/përgjigjeve nga pjesëmarrësit, që ishin më tepër të interesuar në lidhje me sqarime për përmbushjen e kriterëve të regjistrimit dhe procedurat konkrete të zhvillimit të të dy fazave të konkursit.

Në të njëjtën kohë, për të pasur një proces sa më të suksesshëm për thithjen e aplikantëve për konkurs, Shkolla e Magjistraturës, me mbështetjen e projektit JUSTAL të Bashkimit Evropian zbatoi një fushatë komunikimi me objektivin për të rritur informimin e publikut dhe për zgjerimin e përfshirjes së target grupeve në proces, që u realizua në periudhën janar-shkurt 2023. Kjo fushatë komunikimi konsistoi në zbatimin e një plani komunikimi me aktivitete si komunikim i jashtëm (për komunikimin me publikun e gjerë) realizuar nëpërmjet radios shtetërore dhe televizionit shtetëror, shfrytëzimi i mediave dhe mediave sociale (për audiencë specifike të interesuara), si dhe asistencë nga kandidatët aktualë për magjistratë në shkollë për zgjerimin e ndërgjegjësimit të të interesuarve.



Impakti i pritshëm i kanaleve të ndryshme të komunikimit qoftë me publikun e gjerë apo dhe me kategori specifike audiencash është shtrirja më e zgjeruar e fushatës së ndërgjegjësimit për procesin e rekrutimit në mënyrë që të mbërrihet te një publik i interesuar më i gjerë. Njëkohësisht, përdorimi i mediave rrit informacionin për Shkollën dhe vizibilitetin e saj.

- **Bashkëpunimi me Shkollën Kombëtare të Trajnimit të Gjyqtarëve të Greqisë**

Me ftesë të Shkollës Kombëtare të Trajnimit të Gjyqtarëve të Greqisë, një delegacion nga Shkolla e Magjistraturës si dhe gjyqësori dhe prokuroria, mori pjesë në një aktivitet trajnues të Programit të Formimit Profesional të kësaj shkolle. Në përbërje të delegacionit ishin pedagogë dhe punonjës të Shkollës, gjyqtarë dhe prokurorë në detyrë të niveleve të ndryshme të rretheve gjyqësore.

Vizita konsistoi në pjesëmarrjen në dy aktivitete trajnuese njëditore me tematika, si: Shteti i së Drejtës – E Drejta Natyrale – Media Sociale – Ndërhyrjet Politike në procedurat gjyqësore; dhe ditën e dytë në një sesion trajnues të trajnerëve me tematikë martesat e përbashkëta, çështjet familjare ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë – sfida të reja për praktikën dhe procedurën gjyqësore me theks tek impakti i teknologjive të reja dhe medias sociale.



Gjatë ditës së parë u trajtuan tematika të ndryshme si logjika e drejtësisë dhe mënyrat e zbatimit të saj; roli i rrethanave lehtësuese dhe arsyetimi i vendimit; mënyrat e reagimit të gjyqësorit për sa i takon ndërhyrjeve të pushtetit ekzekutiv në fushën e drejtësisë penale; konstruksioni i realitetit social nga media, këndvështrimi i jurisë së gjyqimit dhe i gjyqtarit, si dhe gjyqtari dhe media. Ndërsa dita e dytë ishte një kombinim tematikash për sa i takon trajnimit të trajnerëve dhe më pas tematikave në fushën e të drejtës familjare – martesat ndërmjet shqiptarëve dhe grekëve, dhe teknologjitë e reja në drejtësi dhe sistemet gjyqësore.

Në mbyllje të vizitës, delegacioni zhvilloi një takim pune të zgjatur në Gjykatën e shkallës së parë të Selanikut ku takohet me z. Petro Alikakos, Kryetar i Gjykatës si dhe trajner në Shkollën Greke të Trajnimit Gjyqësor.

Perspektiva

Në zbatim të rolit të tij mbështetës në realizimin e veprimtarisë akademike dhe profesionale të programeve të formimit profesional të Shkollës, Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë synon të mundësojë zbatimin e drejtimeve të mëposhtme në aktivitetin e tij.

1. Vijimi i përfaqësimit dinjitoz të kandidatëve tanë për magistratë në Konkursin Ndërkombëtar THEMIS, ku Shkolla në vijimësi ka fituar pozicione të vlerësuara nga juritë e konkursit.
2. Mundësimi i pjesëmarrjes së pedagogëve, ekspertëve, trajnerëve, gjyqtarëve, prokurorëve në aktivitetet trajnuese të institucioneve të ndryshme të trajnimit gjyqësor të BE-së sipas fushave të interesit.
3. Pjesëmarrje e vazhdueshme e kandidatëve për magistratë në programet e shkëmbimit dhe aktivitetet ndërkombëtare gjyqësore të organizuara nga akademitë e ndryshme gjyqësore në Evropë.
4. Akomodimi dhe harmonizimi i kërkesave për bashkëpunim që vijnë nga donatorë të ndryshëm pa ceduar nga prioritetet e drejtimeve kryesore të proceseve akademike, administrative dhe institucionale të Shkollës, me synimin për të përfituar maksimalisht nga interesi për bashkëpunim i partnerëve ndërkombëtarë.
5. Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve në drejtim të planifikimit strategjik, hartimit dhe zbatimit të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit me donatorët.

L.IV PUBLIKIMET DHE PUNA KËRKIMORE SHKENCORE

L.IV. a Raportim mbi ecurinë e publikimeve dhe kërkimit shkencor për vitin akademik 2022 - 2023

Shkolla e Magjistraturës edhe gjatë vitit akademik 2022-2023 botoi nën emrin dhe kujdesin e saj revista, tekste dhe libra, të cilët kanë trajtuar probleme ligjore të lidhura ngushtë me programet e lëndëve dhe kurseve të Formimit Fillestar e Vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke synuar unifikimin dhe analizimin e praktikës gjyqësore dhe juridike kombëtare e ndërkombëtare. Botimi i këtyre teksteve synon të plotësojë literaturën juridike me njohuri praktike e teorike në ndihmë të gjyqtarëve, prokurorëve që përgatiten rishtas nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe t'u vijë në ndihmë gjyqtarëve e prokurorëve në detyrë, të avokatëve e të përfaqësuesve të tjerë të profesioneve ligjore në procesin e Formimit Vazhdues.

Shkolla e Magjistraturës vijon të ndjekë të njëjtat rregulla për procedurën e botimit, sipas të cilave të drejtën e pronësisë mbi botimin e parë të tekstit e ka Shkolla e Magjistraturës. Ajo ka të drejtën e shpërndarjes së tekstit gjyqtarëve, prokurorëve e juristëve, sipas kushteve të parashikuara¹¹ në kontratën e lidhur midis autorit dhe Drejtorisë së Shkollës. Të drejtën për botim e kanë të gjithë pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës, ekspertët dhe trajnerët e saj, si dhe në raste përjashtimore gjyqtarët, prokurorët e kandidatët për magjistratë, autorë nga profesione të tjera në shërbim të sistemit të drejtësisë, kur botimi ka interes për praktikën gjyqësore dhe formimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Gjatë vitit akademik 2022-2023 Shkolla ndërmori hapa konkretë për rritjen cilësore të produkteve studimore që do të prodhohen nga Departamenti i Studimeve dhe Publikimeve duke krijuar dy hapësira të reja ndërveprimi dhe studimi: a) transkriptimet e aktiviteteve trajnuese të Programit të Formimit Vazhdues, dhe b) krijimin e Forumit të Shkollës së Magjistraturës. Me qëllim qëndrueshmërinë në kohë dhe cilësinë e këtyre aktiviteteve dhe materialeve që ato synohet të prodhojnë, Shkolla hartoi metodologjitë, procesin dhe ngriti grupet e punës në funksion të realizimit të tyre. Vijon puna për përmirësimin dhe zhvillimin e tyre në Shkollë.

¹¹ Përmbajtja e tekstit përfshin të gjitha elementet e një botimi shkencor, si përsa i përket formës, ashtu edhe përmbajtjes. Botimet paraqiten si tekste me natyrë trajnuese, akademike, didaktike e praktike dhe jo më pak se 200 faqe. Teksti është i strukturuar në kapituj, të cilët i përgjigjen strukturës së programit mësimor të lëndës apo kursit përkatës të Formimit Fillestar të miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës, ose në formë monografie kur në to përmbledhen materialet e një seminari të Formimit Vazhdues që lidhet me një temë specifike. Çdo tekst ka jo më pak se 30–40 raste të praktikës gjyqësore për ilustrim, të shoqëruara me referencat përkatëse në vendimet e gjykatës. Teksti mund të përgatitet nga një autor apo grup autorësh, të cilët paraqesin kërkesë me shkrim dhe përbërja e grupit të autorëve miratohet paraprakisht nga Drejtoria e Shkollës. Tekstet që paraqiten për t'u miratuar për botim në Shkollën e Magjistraturës nuk duhet të jenë botuar më parë si libër, tekst, apo botim tjetër, si dhe nuk mund të botohen në të ardhmen pa lejen paraprake me shkrim të Drejtorisë së Shkollës dhe Bordit të Redaktorëve. Tekstet botohen me ISBN dhe me një tirazh të paktën 300 kopje.

L.IV. b Botimi i revistës shkencore “Jeta Juridike”

Shkolla e Magjistraturës botoi nën emrin dhe kujdesin e saj revistën “*Jeta Juridike*”, revistë periodike katërmujore shkencore, që botohet në shqip dhe anglisht, si dhe e pajisur me ISSN.

Gjatë vitit akademik 2022 - 2023 janë botuar nr. 3 viti 2021, 2 numra të vitit 2022 dhe është në proces botimi nr. 1 për vitin 2023 të revistës “*Jeta Juridike*”. Botimi i këtyre numrave për këtë vit akademik është financuar nga buxheti i shtetit.

Nr.	Titujt e botimeve	Nr. i kopjeve	Financimi	Gjendja
1	Revista “ <i>Jeta Juridike</i> ” nr. 3, 2021	300	Nga buxheti	Është botuar
2	Revista “ <i>Jeta Juridike</i> ” nr. 1, 2, 2022	300	Nga buxheti	Është botuar

Shkolla e Magjistraturës i konsideron shpenzimet lidhur me revistën, si të domosdoshme për vazhdimësinë e një aktiviteti, që në të gjitha aspektet, përbën një arritje për institucionin si dhe një kontribut të rëndësishëm për doktrinën juridike të vendit tonë. Këtë vendim, strukturat drejtuese të Shkollës e morën duke u nisur nga komentet shumë pozitive për cilësinë dhe seriozitetin e revistës nëpër takime të ndryshme me juristë nga i gjithë vendi. Veç kësaj, mjaft gjyqtarë, prokurorë e juristë të tjerë, madje pena të njohura të drejtësisë shqiptare, kontaktojnë vazhdimisht me redaksinë për të botuar artikujt e tyre. Kjo natyrisht flet për sukses cilësor të revistës dhe për pritjen e mirë të saj nga lexuesi. Por, nga ana tjetër, kjo e vendos redaksinë e revistës përpara një përgjegjësie të madhe që t’i përgjigjet edhe në kohë lexuesit që e pret me padurim daljen e revistës.

Mbetet një sfidë e rëndësishme për institucionin vazhdimi i botimit të saj në vitet në vazhdim me fondet e buxhetit të shtetit, ku parashikohet edhe shitja e saj dhe përdorimi i të ardhurave për botimin e numrave të ardhshëm të revistës. Janë në proces dhe numrat 1, 2, 3 të vitit 2023 të revistës “*Jeta Juridike*”.



Numrat e revistës “*Jeta Juridike*”, për vitet 2022-2023, janë përgatitur me rreth 190 faqe (\pm 10 faqe) secila. Artikujt janë në gjuhën shqipe me abstrakt edhe në anglisht. Revista botohet në një tirazh prej 300 kopjesh dhe kopertina pasqyron emblemën (logon) e Shkollës së Magjistraturës. Si përfitues të botimit shkencor “*Jeta Juridike*” janë identifikuar gjyqtarët dhe

prokurorët në të gjithë vendin, pedagogët e Shkollës si dhe të fakulteteve të drejtësisë në vend, si dhe studentët e Shkollës së Magjistraturës, pa lënë mënjanë edhe studentët e drejtësisë, avokatët, noterët, juristët e institucioneve dhe organizatave etj.



I.IV. c Botimi i revistës “Magjistrati”

Për vitin akademik 2022-2023 është botuar “Magjistrati 13 dhe 14”, revistë me punimet e kandidatëve për magjistratë të vitit të dytë dhe janë në proces nr.15 dhe nr.16.




I.IV. d Botime tekstesh dhe librash

Gjatë vitit akademik 2022 – 2023 është botuar edhe komentari me titull “Komentari i Kodit të Etikës Gjyqësore” me autor pedagogun e brendshëm të Shkollës, z. Arben Isaraj, i cili u mirëprit nga të gjithë përdoruesit e së drejtës dhe menjëherë filloi të përdorej nga magjistratët.



Gjithashtu, gjatë periudhës 2022-2023 në bashkëpunim me Komitetin Drejtues të Projektit të Këshillit të Lartë të Magjistraturës Italiane është bërë e mundur botimi me titull “Përmbledhje e jurisprudencës italiane dhe shqiptare mbi masat parandaluese kundër pasurisë”.



L.IV. e Kriteret e zbatuara për botimet e Shkollës, të revistës “Jeta Juridike” dhe të teksteve

Rregullorja e revistës shkencore “Jeta Juridike” parashikon standarde të larta përzgjedhjeje për artikujt që botohen në këtë revistë. Kështu disa nga kriteret e zbatuara kanë qenë dhe janë:

- përzgjedhja e botimeve dhe shkrimeve nga autorë që përfaqësojnë personalitete juridike;
- heterogjeniteti i autorëve. Revista pasqyron shkrime nga juristë të moshave të ndryshme, të profileve të ndryshme, të rretheve të ndryshme;
- përkthimi i disa autorëve të huaj lidhur me shkrime që vlerësohen si të rëndësishme dhe bashkëkohore për t’u trajtuar edhe në kontekstin shqiptar;
- larmia e temave që prekin aspekte të ndryshme të teorisë dhe praktikës së të drejtës;
- konceptimi i artikujve dhe strukturës së tyre në mënyrë të tillë që t’u shërbejnë gjyqtarëve apo prokurorëve, duke qenë se ata do të jenë lexuesi kryesor, por edhe juristëve të rinj. Kështu edhe kur artikujt kanë trajtuar çështje të së drejtës ndërkombëtare apo asaj të huaj, gjithmonë ato janë parë edhe nga këndvështrimi i realitetit shqiptar;
- përzgjedhja e artikujve të pasur me shembuj nga praktika;
- seleksionimi i shkrimeve mbi bazën e risive dhe origjinalitetit shkencor që ato përcjellin te lexuesi, duke shmangur shkrimet me ngjyrime politike apo emocionale;
- përzgjedhja e artikujve edhe mbi bazën e formatit shkencor të paraqitjes së tyre, strukturës, bibliografisë, citimeve etj.

L.IV. f Miratimi i botimeve shkencore nga Bordi i Redaktorëve

Bordi i Redaktorëve të Botimeve. Botimet shkencore nën logon dhe emrin e Shkollës, si revista “Jeta Juridike” dhe tekstet e tjera, realizohen me vendim të Bordit të Redaktorëve. Bordi i redaktorëve është një organ vendimmarrës që përbëhet nga 7-9 anëtarë, të cilët propozohen nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i saj. Kriteret e përzgjedhjes së tyre janë përcaktuar në VKM-në nr. 241, datë 6.4.2011, “Për veprimtarinë

akademike, në zbatimin e programit të Formimit Fillestar dhe Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës”.

Bordi i Redaktorëve

Prof. asoc. dr. Sokol SADUSHI

Arben RAKIPI

Prof. dr. Aurela ANASTAS

Prof. dr. Mariana SEMINI

Prof. dr. Arta MANDRO

Prof. dr. Argita MALLTEZI

Prof. dr. Skënder KAÇUPI

Prof. dr. Eralda MET'HASANI

Z. Dashmir KORE

Struktura e revistës

Struktura e revistës “Jeta Juridike”, miratuar nga Bordi i Redaktorëve, vazhdon të jetë e njëjtë edhe për vitin akademik 2022-2023 me rubrikat si më poshtë:

- Rubrika 1 - Artikuj teorikë
- Rubrika 2 – Opinione dhe debat juridik
- Rubrika 3 – Njohje me legjislacionin e ri
- Rubrika 4 – Njohje me praktikën gjyqësore
- Rubrika 5 – Njohje me përvojën ndërkombëtare teorike dhe praktike
- Rubrika 6 – Shkrime nga juristë të rinj
- Rubrika 7 – Aktivitete të Shkollës së Magjistraturës
- Rubrika 8 – Artikuj të spikatur “*Botime e artikuj të përkthyer nga periodikë të ndryshëm ndërkombëtarë*”
- Artikujt e rubrikave të mësipërme kanë nga një ekstrakt të përkthyer në anglisht.

L.IV. g Puna kërkimore shkencore 2022-2023

Shkolla e Magjistraturës gjatë vitit akademik 2022-2023 ka zgjeruar fushën e publikimeve, pasi me vendimin nr. 11, datë 16.3.2023 të Këshillit Drejtues, u vendos për realizimin e një produkti të ri, konkretisht, përmbledhjen e transkriptimeve të disa aktiviteteve të Programit të Formimit Vazhdues.

Në Aneksin 15 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, u bë një shtesë në nenin 4/1 e cila parashikon se:

Shkolla e Magjistraturës (SHM) boton në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, përmbledhje të transkriptimeve të përmbajtjes së trajnimeve të zhvilluara në programin e formimit vazhdues. Përmbledhjet e transkriptimeve grupohet sipas fushave:

- *E drejta kushtetuese dhe të drejtat e njeriut;*
- *E drejta administrative;*
- *E drejta penale (materiale dhe procedurale);*
- *E drejta civile (materiale dhe procedurale);*
- *Aftësi dhe kompetenca joligjore.*

Për hartimin dhe përgatitjen e përmbledhjeve të transkriptimit sipas fushave të përmendura në pikën 2 të këtij neni, SHM-ja mund të angazhojë kandidatë për magjistratë, që kanë përfunduar programin e vitit të dytë të formimit fillestar. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në renditjen e tyre në vlerësimin përfundimtar të vitit të dytë, duke filluar nga kandidati që është renditur i pari.

Gjatë këtij procesi, kandidatët për magjistratë udhëhiqen nga një grup pedagogësh/ekspertësh të fushave respektive.

Përfshirja e kandidatëve të përzgjedhur në këtë veprimtari të SHM-së shërben për të nxitur angazhimin e tyre në fushën e botimeve dhe në programin e formimit vazhdues pas diplomimit.

Në përmbushje të këtij detyrimi nisi hartimi i një metodologjie dhe përcaktimi i një procesi të qartë pune që përfshin Sektorin e Studimeve dhe Publikimeve, pedagogët përgjegjës të çdo fushe të përcaktuar si më lart dhe kandidatët për magjistratë, të cilët shprehën vullnetin e tyre për të qenë pjesë e këtij procesi.

Shkolla ka filluar realizimin e transkriptimeve dhe ecuria e tyre do të jetë pjesë e raportimit dhe analizës për vitin akademik 2023-2024.

Shkolla ka hapur gjithashtu një hapësirë të re ndërveprimi, nëpërmjet krijimit të Forumit të Shkollës së Magjistraturës. Kjo hapësirë lejon shkëmbimin e mendimeve mbi çështje të ndryshme të së drejtës dhe diskutimin e praktikave gjyqësore. Qëllimi i këtij forumi është që, nëpërmjet diskutimit të magjistratëve dhe subjekteve të tjera të sistemit të drejtësisë, të përftohet një thellim dhe evoluim i dijes dhe mendimit kritik, i cili më tej, do të sjellë pasoja të dëshirueshme afatgjata për cilësinë e drejtësisë në vend.

Forumit synohet të prodhojë dy lloj materialesh: a) përmbledhje të përpunuara të diskutimeve të realizuara; b) material me natyrë studimore dhe/ose akademike. Raportimi mbi ecurinë e tij do të bëhet në vitin e ardhshëm akademik.

I.IV. h Objektivat e publikimeve dhe punës kërkimore shkencore 2023-2024

Kërkimi shkencor dhe publikimi mbeten pika kyçe të veprimtarisë dhe prioriteteve të Shkollës. Gjatë periudhës 2023-2024, lidhur me prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara në planin strategjik të Shkollës së Magjistraturës, ky program do të fokusohet në:

1. botimin në emrin dhe kujdesin e Shkollës të teksteve dhe librave të cilët trajtojnë probleme ligjore të lidhura ngushtë me programet e lëndëve dhe kurseve të Formimit Fillestar e Vazhdues të gjyqtarëve e prokurorëve, duke synuar në unifikimin dhe analizimin e praktikës gjyqësore e juridike kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. botimin e titujve me praktikë gjyqësore (Case study) dhe publikime të tjera shkencore në funksion të studiuesve të së drejtës;
3. përgatitjen e manualeve, moduleve/cikleve të leksioneve për lëndë apo tema që trajtohen në procesin e Formimit Fillestar të magjistratëve, nga grupe autorësh;
4. botimin, në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, të përmbledhjeve të transkriptimeve të përmbajtjes së trajnimeve të zhvilluara në Programin e Formimit Vazhdues;
5. publikimin e revistave shkencore dhe publikimeve të tjera sipas Rregullores në mënyrë periodike;
6. ngritjen e grupeve të studimit dhe kërkimit në fusha prioritare të së drejtës, të përzgjedhur nëpërmjet një metodologjie të hartuar për këtë qëllim si dhe ofrimin e trajnimit për kërkuesit e rinj që i bashkohen grupeve të studimit/kërkimit;
7. krijimin e një grupi pune të përhershëm që realizon punë paraprake kërkimore dhe analizuese në funksion të studimit të grupeve të ngritura, i cili do të parashikojë kohën se

- kur mund të publikohen produktet e përfuara, mundësitë dhe mjetet për rritjen e vizibilitetit të produkteve;
8. përdorimin e metodave teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve që lehtësojnë dhe nxisin bashkëpunimin mes Shkollës dhe subjekteve të saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në vend dhe atyre ndërkombëtarë, duke siguruar ndërveprim të gjerë dhe vizibilitet të lartë të Shkollës;
 9. përdorimin e moduleve të shumta e-learning të prodhuara në Evropë ose të krijuara në Shkollë;
 10. shkëmbimin e burimeve (dokumente, botime shkencore, kurikula trajnimi dhe çdo “mjet trajnimi” tjetër, i cili do të mund të kontribuojë në përmirësimin e njohurive dhe dijeve të sistemeve gjyqësore dhe juridike përkatëse) me shkolla homologe dhe partnerë kombëtarë/ndërkombëtarë;
 11. zhvillimin e kapaciteteve të saj për të dorëzuar dhe menaxhuar projekte që lidhen me trajnimin gjyqësor, veçanërisht në kuadër të Programit të BE-së për Drejtësi dhe në partneritet me EJTN-në dhe anëtarët e saj;
 12. pasurimin në mënyrë të vazhdueshme të bibliotekës digjitale;
 13. zhvillimin dhe përmirësimin e platformave dhe Forumit të Shkollës së Magjistraturës.

I.IV. i Biblioteka

Zhvillimi i fondit të bibliotekës përmes pasurimit të tij dhe përmirësimi i vazhdueshëm i qasjes në bibliotekë të kandidatëve për magjistratë që ndjekin Formimin Fillestar, magjistratëve në detyrë, stafit pedagogjik, stafit administrativ etj., është synim i vazhdueshëm i Sektorit të Studimeve dhe Publikimeve.

Fondi i Bibliotekës është pasuruar me literaturë të re në fushën e drejtësisë. Tituj të rinj i janë shtuar fondit të librit në gjuhën shqipe dhe fondit të librit në gjuhë të huaj. Pasurimi dhe informacioni bibliografik i titujve të rinj pasqyrohet në bazën lokale të të dhënave bibliografike *Cobiss Shmt* dhe katalogu digjital vazhdon të jetë lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë përdoruesit në aneksin e bibliotekës në faqen e shkollës në *Web*.

Platforma e bibliotekës digjitale të Shkollës është pasuruar me monografi dhe revista në format digjital. Kemi vazhduar punën për prezantimin e saj dhe nxitjen e përdoruesve për t'u qasur në këtë platformë e për të shfrytëzuar burimet që ajo ofron.

Kandidatëve për magjistratë u është prezantuar dhe ofruar për përdorim edhe platforma *Cobiss Unpay Wall*, platformë digjitale e cila ofron qasje në mbi 50 000 artikuj shkencorë me tekst të plotë, në fusha të ndryshme të dijes, përfshirë edhe jurisprudencën.

Në sallën e bibliotekës është instaluar një skaner libri, i cili po përdoret për digjitalizimin e disa botimeve të Shkollës, të cilat duhet t'i shtohen bibliotekës digjitale, por nuk ka format digjital të tyre. Ky skaner ka zëvendësuar përdorimin e fotokopjimit të lejuar të tekstit (deri në 15 faqe) duke e lehtësuar përdorimin dhe shpërndarjen e materialit nga kandidatët për magjistratë gjatë studimit, duke nxitur kështu të punuarit *paper free*.

I.V ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Viti akademik 2022-2023 shënoi hapa cilësorë të rëndësishëm në drejtim të përdorimit të teknologjisë së informacionit, në funksion të performancës së Shkollës dhe rritjes së efektivitetit të saj në procese të ndryshme akademike dhe administrative.

Rritja e përdoruesve të Shkollës u shoqërua me shtim të intensitetit të aktiviteteve mësimore dhe trajnuese. Shkolla e Magjistraturës u angazhua për të digjitalizuar më tej procesin e mësimdhënies dhe trajnimeve dhe si rrjedhojë, Sektori i Teknologjisë së Informacionit me mbështetjen e Sektorëve të Formimeve Fillestar dhe Vazhdues ndërmoren një sërë masash për arritjen e këtij objekti duke siguruar pajisjet dhe mjetet elektronike të nevojshme për zhvillimin e këtyre aktiviteteve.

Gjatë këtij viti akademik, Sektori i Teknologjisë së Informacionit u angazhua me disa programe digjitalizimi si më poshtë:

I.V. a Platforma SMVSHM

Një arritje e rëndësishme e këtij viti ishte edhe zhvillimi dhe lançimi i platformës SMVSHM (Sistemi i Menaxhimit të Veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës), i cili mundëson menaxhimin digjital të Sektorit të Formimit Fillestar (FF) dhe të Sektorit të Formimit Vazhdues (FV).

Sistemi bazohet në teknologjinë web, në mënyrë që të jetë i aksesueshëm online, nga çdo pajisje fundore që ka mundësinë të lidhet me internet. Ky sistem përmban të gjitha të dhënat e duhura për kandidatët për magjistratë, në mënyrë që t'u lehtësojë atyre dhe pedagogëve procesin e mësimdhënies, por gjithashtu dhe procesin e trajnimeve të vazhdueshme të Programit të Formimit Vazhdues. Platforma është në zhvillim të mëtejshëm në mënyrë që të përmirësohet.

Sistemi i Menaxhimit dhe Veprimtarisë së SHM-së (Shkollës së Magjistraturës) është një platformë menaxhimi e të dhënave, e cila do të mundësojë menaxhimin digjital të Sektorit të Formimit Fillestar (FF) dhe të Sektorit të Formimit Vazhdues (FV). I bazuar në teknologjinë web, në mënyrë që të jetë i aksesueshëm online, nga çdo pajisje fundore që ka mundësinë të lidhet me internet, ky sistem u krijua për të përmbushur këto qëllime kryesore:

- rritjen e cilësisë së komunikimit ndërmjet aktorëve aktivë të veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës;
- rritjes së cilësisë së komunikimit me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë;
- rritjen e efikasitetit të punimit të bazës së të dhënave;
- rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes.

Drejtimit kryesorë të sistemit:

1. Regjistër i përbashkët i të dhënave dhe dokumenteve.

Të gjithë dokumentet e studentëve janë në një repositor të përbashkët: dokumentet (originale digjitale ose të skanuara), të cilat aksesohen lehtësisht nga aktorët specifikë sipas detyrës.

2. Portal për regjistrimin elektronik, njoftimin elektronik dhe aksesin online.


3. Regjistrimi online, në mënyrë digjitale të studentëve konkurrues dhe njoftimi i tyre për çdo zhvillim, në lidhje me procesin e tyre mësimor.


4. Aksesimi në çdo kohë dhe nga çdo pajisje, prej të gjithë përdoruesve që u është dhënë e drejta.


5. Komunikimi me institucionet e tjera të drejtësisë përmes një kanali të sigurt.

6. Përdoruesit e jashtëm të institucioneve ndërlidhëse, pas identifikimit të tyre të sigurt elektronik në platformë, do të shkëmbejnë në mënyrë të sigurt dokumentet nga sistemet e tyre të menaxhimit dhe do ta sinkronizojnë informacionin automatikisht.


Proceset komplekse të punës, të cilat do të pasqyrohen në sistem, duke nisur që nga “Procesi i konkurrimit në Shkollën e Magjistraturës” dhe deri në procesin e mësimdhënies janë paraqitur në skemat më poshtë:







Në figurat më sipër paraqitet qartë flow i punës (hapat e punës), për mënyrën se si do të funksionojë sistemi për procesin e “Programit të formimit fillestar” dhe “Programit të formimit vazhdues”.



Platforma SMVSHM do të jetë një arritje e madhe inovative për Shkollën e Magjistraturës, duke bërë të mundur digjitalizimin e të gjitha të dhënave të saj ndër vite, për të bërë sa më transparent procesin e konkurrimit në Shkollë dhe për të lehtësuar sa më shumë procesin e mësimdhënies, duke e bërë atë një shkollë avangarde, sipas standardeve të shkollave homologe nëpër botë.

I.V. b Forumi i Shkollës së Magjistraturës

Forumit profesional, një risi e madhe e këtij viti akademik, me pjesëmarrje të magistratëve, këshilltarëve/ndihmësve ligjorë, avokatëve të shtetit, kancelarëve dhe subjekteve të tjera përfituese të programeve në Shkollë, apo persona të tjerë të interesuar të sistemit të drejtësisë në vend, do të shërbejë si hapësirë diskutimi për çështje të ndryshme të së drejtës.

Veçantia e forumit, si një hapësirë miqësore në përdorim është që lejon një gjuhë sa profesionale aq edhe të thjeshtë për dhënien e mendimeve, duke mundësuar akses në çdo moment të ditës pa qenë shumë impenjative për përdoruesin. Këto shihen si pika të forta në efektivitetin e këtij mjeti pedagogjik-praktik. Në vijim do të shohim nëpërmjet figurave ilustruese, funksionimin e ndërfaqes së forumit:



Në figurën më sipër paraqitet dritarja kryesore, kur aksesohet forumi në linkun: <https://forum.magjistratura.edu.al/>.

Në këtë dritare ka hapësirë për t'u regjistruar të gjithë përdoruesit e rinj të forumit dhe gjithashtu, hapësira për t'u identifikuar për përdoruesit ekzistues.




Me një ndërfaqe të thjeshtë përdorimi (user-friendly), përdoruesi pasi identifikohet i shfaqet një dritare si në figurën 17, ku i jepet mundësia për të nisur një diskutim të ri, ose të shohë të gjithë diskutimet ekzistuese, ku bën pjesë. Gjithashtu, kur përdoruesi hyn në profilin e vet, ka mundësi të shohë të gjitha njoftimet mbi diskutimet në kohë reale, nëse ka komente apo zhvillime të mëtejshme, duke pasur dhe mundësinë e kërkimit sa më të lehtë e të shpejtë.

Në figurën më poshtë paraqitet një pamje, shkëputur nga një diskutim i kryer më parë, për një temë të caktuar, ku tregohen të gjitha detajet e përmendura më sipër në kohë reale.

The screenshot shows a forum interface. At the top, there is a dark blue header with the text 'Forumi i Shkollës së Magjistraturës' and a search icon. Below the header is a green banner with the text 'Procedurë Penale' and 'Roli dhe funksionet e gjyqtarit të seancës paraprake'. The main content area features a post by a user with a profile picture 'H' and a name 'shmadmin' (partially obscured). The post text discusses legal reforms and the role of judges in pre-trial proceedings. To the right of the post, there are buttons for 'Përgjigju' (Reply) and 'Ndiq' (Follow). Below the post, there is a section for 'Postimi original' (Original Post) with a date of 'October 2023'. At the bottom, there is a button to 'Shkruaj një përgjigje...' (Write a reply...) next to the forum's logo.

Gjithashtu, përdoruesit të identifikuar në forum i jepet mundësia që të kryejë cilësimet për profilin e vet sipas preferencës. Në figurën më poshtë paraqiten këto opsione, së bashku me opsionin e daljes nga forumi.




Shkolla e Magjistraturës i jep mundësinë për pjesëmarrje në forumin profesional edhe gjithë personave të tjerë të interesuar, që nuk janë subjekte përfituese të programeve në Shkollë, nëpërmjet një kërkesë në adresën elektronike: forum@magjistratura.edu.al. Në momentin që ata konfirmohen, procedura e punës dhe hapat janë të njëjtë me ato të përdoruesve ekzistues të stafit të Shkollës.

I.V. c Biblioteka Digjitale

Ndërtimi i Bibliotekës digjitale, të mbështetur financiarisht nga Këshilli i Evropës, vazhdon të zhvillohet me materiale për magjistratët, gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, kancelarët e gjykatave dhe të gjitha rolet e përdoruesve në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që materialet, librat apo dhe revistat e publikuara nga Shkolla e Magjistraturës, të mund të gjenden vetëm një klikim larg online.

<https://biblioteka.magjistratura.edu.al>



I.V. d Digjitalizimi i mësimdhënies

Në kuadër të zhvillimit të metodologjive të mësimdhënies, Shkolla e Magjistraturës është angazhuar të përfshijë maksimalisht teknologjinë dhe lehtësimin e mësimdhënies në mjediset/sallat e mësimi.

Në vazhdimësi të procesit të përfshirjes së paneleve interaktive në salla i cili nisi vitin e kaluar akademik, është prokuruar dhe 1 (një) panel interaktiv 65”, i cili do të shërbejë për sallën një të Shkollës së Magjistraturës. Ky panel i cili operon me sistem Android dhe ka gjithashtu një OPS PC të bashkangjitur, i vjen në ndihmë pedagogëve, trajnuesve, ekspertëve dhe lehtësuesve në shfaqjen e materialeve, prezantimeve, videove, fotove apo në disa raste dhe konvertimin e sallës ku ndodhet paneli në sallë hibride – ku aktiviteti ndiqet dhe nga platforma Zoom.


Në mbështetje të sallave hibride, u bë i mundur dhe sigurimi i mikrofonëve sensitivë, të cilët lidhen me panelet interaktive dhe lejojnë regjistrimin dhe dëgjimin e zërit në sallë deri në 10m+.

Gjithashtu, u siguruan dhe 10 (dhjetë) laptopë praktikë, të cilët e çojnë numrin total të laptopëve në Shkollën e Magjistraturës në 80 (tetëdhjetë). Përveç faktit që punonjësit mund të aksesojnë sistemet e Shkollës dhe të punojnë nga shtëpia, pra në një sistem hibrid, laptopët mundësojnë procesin e mësimdhënies në auditor, por edhe përdorimin e tyre gjatë sezonit të provimeve të vitit të parë dhe të vitit të dytë. Laptopët konfigurohen përpara se të fillojë provimi duke i hequr programet që mund të aksesojnë internetin, konfigurohen gjithashtu me IP statike në mënyrë që mos të lidhen me asnjë hotspot si dhe lidhen në një sistem me router dhe printer në mënyrë që të printojnë wireless-ly (pa fisha), proces që realizohet me sukses nga bashkëpunimi midis Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Sektorit të Formimit Fillestar.

Course categories: Formimi Fillëstar 2022

Search courses

- › E Drejte Familjare
- › E Drejte Civile
- › E Drejte Penale
- › Procedure Civile
- › Procedure Penale
- › E Drejte Administrative
- › Arsyetim dhe Shkrim Ligjor
- › E Drejte Kushtetuese
- › E Drejte Nderkombetare Private
- › E Drejte Tregtare dhe e Kompanive
- › Administrimi i Gjykatave
- › E Drejte e Punes dhe Sigurimeve Shoqerore
- › Pronesi Intelektuale
- › Ndermjetesim Arbitrazhi
- › E Drejte Tregtare dhe e Kompanive
- › Etike Profesionale
- › E Drejte e Bashkimit Evropian
- › Ndermjetesim Arbitrazh



Shkolla e Magjistratures

School of Magistrates at Albanian School of Magistrates

Tirana, Albania · [Contact info](#)

1,448 followers · 500+ connections

Shkolla e Magjistraturës, me qëllim rritjen e vizibilitetit të aktiviteteve të saj dhe duke marrë në konsideratë se, një pjesë e madhe e përdoruesve janë të një grupmoshe të re, ka dhe profilin e saj në rrjetin “Facebook”, me adresë <https://www.facebook.com/Shkollaemagjistratures>, ku pasqyron aktivitetet më të rëndësishme ditore dhe njoftimet në kohë reale. Gjatë vitit akademik u përditësua gjithashtu, profili dhe faja e Shkollës së Magjistraturës në **LinkedIn** ku pasqyrohen aktivitetet e ndryshme të shkollës (figurat më sipër).

KREU II PRIORITETET E SHKOLLËS PËR VITIN E RI AKADEMIK 2023-2024

KREU II PRIORITETET E SHKOLLËS PËR VITIN E RI AKADEMIK 2023-2024

II. I. a Për Programin e Formimit Fillestar

Së pari, prioritet për vitin e ri akademik 2023-2024 do të vijojë të jetë *realizimi i provimit të pranimit* për rekrutimin e magjistratëve, këshilltarëve e ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve në gjykata e prokurori, prioritet i cili do të ketë në fokus përmirësimin e metodologjisë së hartimit të tezave të provimit. Ndërtimi i tezave do të synojë anën praktike të funksionimit të ligjit, në përpjekje për t'u larguar sa më shumë të jetë e mundur nga ana teorike. Do të vijojë të kërkohet që nëpërmjet provimit të pranimit të evidentohet aftësia logjike dhe interpretuese e konkurrentit, duke synuar përthithjen e prurjeve më të mira për kandidatët për magjistratë.

Shkolla synon gjithashtu që të realizojë testimin profesional të kancelarëve në detyrë dhe provimin e pranimit të kandidatëve për kancelarë në gjykata dhe prokurori, nëse Këshillat do të shpallin kuota të lira.

Së dyti, prioritet i Shkollës do të vijojë të jetë *zhvillimi me standarde të larta i procesit mësimor*. Ky prioritet do të realizohet duke pasur në vëmendje objektivat specifike, si më poshtë:

1. Programi mësimor trevjeçar do të shoqërohet me kurikula të standardeve bashkëkohore, në përshtatje me nevojën e kandidatit në momentin që do të nisë rolin e tij si gjyqtar apo prokuror i sistemit. Këto kurikula do të konceptohen në formën e moduleve të strukturuar, sipas një programi të riparë në mënyrë tërësore;
2. Vlerësimi i kandidatëve do t'i përshtatet mënyrës së re të konceptimit të kurikulave dhe do të synojë vlerësimin e aftësive dhe kompetencave të fituara nga ana e tyre;
3. Kurikulat do të vijojnë të përfshijnë praktikë dhe çështje të trajtuara nga ligji i BE-së dhe praktika ndërkombëtare, në mënyrë që kandidatët për magjistratë të jenë në gjendje ta përdorin ligjin e BE-së apo atë ndërkombëtar në çdo rast që do t'u paraqitet në punën e tyre;
4. Çështje të etikës, integritetit, sjelljes dhe aftësive të tjera “soft skills” janë pjesë e rëndësishme e objektivave mësimore dhe trajtimi i tyre do të bëhet pjesë integrale e kurikulave;
5. Përmirësimi i praktikave për realizimin e provimit përfundimtar të vitit të dytë, i cili zhvillohet në përfundim të ciklit teorik dhe praktik-teorik të studimeve, për ta bërë vlerësimin përfundimtar, sa më të dobishëm dhe në funksion të klasifikimit të kandidatëve. Duhet theksuar rëndësia e këtij provimi në vlerësimin përfundimtar nga ana e Këshillit Pedagogjik, të kandidatëve për magjistratë, pas përfundimit të vitit të dytë;
6. Viti i dytë i Programit të Formimit Fillestar do të rishikohet në mënyrë që ai të krijojë të gjithë mundësinë për përthithjen e aftësive praktike dhe diskutimin e tyre në Shkollë në mënyrë eficiente;

7. Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për praktikën profesionale të vitit të tretë me qëllim harmonizimin e kërkesave të këtij viti dhe vlerësimit të tij me dy vitet e para të realizuara dhe vlerësuara nga SHM-ja. Shkolla do të vlerësojë mundësinë e përmirësimit të kontakteve me magjistratët udhëheqës të praktikës profesionale. Shkolla do të vlerësojë edhe mendimin e kandidatëve për magjistratë, pas plotësimit të pyetësorëve nga ana e tyre për magjistratët e tyre udhëheqës. Pyetësorët e vlerësimit për magjistratin udhëheqës nga kandidati për magjistrat do të plotësohen gjatë periudhës së praktikës. Në përfundim të vitit akademik, Këshilli Pedagogjik do të hartojë një propozim më të plotë për vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë dhe programin e udhëheqësve, si dhe do të kryejë një vlerësim të performancës së praktikës profesionale, duke bërë një pasqyrim të gjithë situatës, performancës së secilit kandidat, si dhe punën e kryer nga secili prej magjistratëve udhëheqës;
8. Hartimi i një programi të përshtatshëm për ndjekjen e trajnimeve sipas Programit të Formimit Vazhdues nga kandidatët e vitit të tretë të Shkollës, jo vetëm kundrejt zgjedhjes së temave të seminareve prej tyre, por edhe përzgjedhjes së temave të detyrueshme për t'u ndjekur nga Shkolla, meqenëse viti i tyre i praktikës aktive është jo vetëm një vit prove përshtatshmërie direkte me profesionin, por edhe një vit formimi;
9. Hartimi dhe realizimi i një programi të posaçëm për gjyqtarët dhe prokurorët për të cilët organet e rivlerësimit do të vendosin ndjekjen e një kursi trajnimi në Shkollë, që i përgjigjet eksperiencës, përgatitjes dhe boshllëqeve që ata kanë;
10. Organizimi i një programi tremujor për kandidatët për kancelarë si pjesë e Programit të Formimit Fillestar të tyre.

Së treti, Shkolla do të vijojë të angazhohet maksimalisht në kërkesën për ***standarde ekselente në përzgjedhjen e stafit pedagogjik***. Ky rezultat vjen si përmbushje e disa objektivave:

1. Rekrutimi i stafit pedagogjik bazuar në meritë dhe me transparencë të plotë nga ana e Shkollës, duke respektuar kriteret dhe rregullat e përcaktuara në ligj dhe në Rregulloren e Brendshme të Shkollës, si dhe trajnimi i tyre. Këtu kemi parasysh hartimin e një programi për trajnim trajnerësh për trajnerët ekzistues dhe për çdo trajner të ri, që futet rishtazi në Shkollë, para se të fillojë nga puna, me qëllim unifikimin e metodave të mësimdhënies, duke ruajtur parimet e pavarësisë akademike. Gjithashtu, do të parashikohen trajnime të veçanta për gjyqtarët dhe prokurorët udhëheqës të praktikës profesionale të kandidatëve. Një prioritet lidhur me stafin akademik do të jetë edhe krijimi i mundësive për përfshirje të profesorëve/lektorëve ndërkombëtarë në Programin e Formimit Fillestar;
2. Rritja e efikasitetit të vlerësimit të Formimit Fillestar nga vetë kandidatët për magjistratë. Sistemi i vlerësimit të nivelit të Formimit Fillestar, ku kryesisht kandidatët për magjistratë shprehen anonimisht për nivelin e organizimit të procesit mësimor, duke filluar nga programet, struktura e tyre, tematika, metodologjia, pedagogët dhe specialistët, me qëllim që të pasqyrohen ndryshimet për vitet e ardhshme akademike. Për të rritur shkallën e profesionalizmit në mësimdhënie, duhet të bëhet kujdes në zbatimin e sistemit të vlerësimit të pedagogëve, për të parë nëse ka nevojë për ndryshime në listën e tyre, si dhe në grupet e lëndëve, të parashikuara në programet mësimore. Procesi i vlerësimit të pedagogëve të Formimit Fillestar realizohet në fund të çdo viti akademik dhe kryhet fillimisht nga kandidatët për magjistratë, të cilët plotësojnë pyetësorët në fund të çdo viti akademik, duke respektuar anonimat. Përgjegjësi i Formimit Fillestar përgatit një relacion me shkrim në fund të çdo viti akademik me vlerësimet për punën e çdo pedagogu/specialisti të aktivizuar gjatë vitit akademik të cilin ia drejton Drejtorit të Shkollës. Drejtori i Shkollës, çdo fillim viti akademik përgatit një raport për Këshillin

Drejtues mbi rezultatet e vlerësimit të pedagogëve/specialistëve gjatë vitit pararendës akademik, së bashku me propozimet për marrjen e masave për largimin apo ndryshimin e atyre që nuk plotësojnë kriteret, me qëllim që Këshilli Drejtues të realizojë vendimmarrjen e tij në formën e dhënies së *Vlerësimit Përfundimtar*. Ky proces do të detajohet dhe përmirësohet.

Së fundmi, Shkolla konsideron të rëndësishëm *forcimin e marrëdhënieve me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë* si rrjedhojë e detyrimeve dhe interesit të përbashkët për forcimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë. Për përmirësimin e këtij rezultati do të synohet:

1. bashkëpunimi dhe konsultimi lidhur me vendet vakante dhe nevojat e gjyqësorit dhe prokurorisë për gjyqtarë e prokurorë të rinj, për të parë se si do të riorganizohen gjykatat/prokuroritë dhe strukturat e tyre;
2. bashkëpunimi për verifikimin në kohë nga ana e Shkollës e plotësimit të kriterëve për konkurrentët dhe e verifikimit të pastërtisë së pasurisë dhe figurës nga ana e këshillave;
3. këshillimin për analizimin e nevojave dhe drejtimeve që organet e qeverisjes do të konsiderojnë të përshtatshme për t'u përfshirë në programin e formimit fillestar në Shkollë.

II. I. b Për Programin e Formimit Vazhdues

Viti akademik 2023-2024 do të jetë një vit intensiv për sa i takon vlerësimit cilësor të aktiviteteve trajnuese, rishikimit të metodologjisë dhe planifikimit të një programi trajnimi të specializuar dhe të ndarë në kohë.

Programi i Formimit Vazhdues do të orientohet drejt temave më të rëndësishme për të cilat kërkesat e magistratëve kanë qenë të larta dhe do të përshtatet me nevojën për trajnim të magistratëve të rinj në sistem, por edhe me nevojat që burojnë nga zhvillimi i karrierës në gjyqësor dhe prokurori.

Së pari, prioriteti kryesor i Shkollës do të jetë cilësia e ofrimit të trajnimeve dhe vlerësimi i trajnimeve, si nga këndvështrimi i ekspertëve, ashtu edhe i pjesëmarrësve. Për të arritur këto rezultate, Shkolla ka vendosur disa objektiva.

1. Përmirësimin e metodologjisë së mbledhjes dhe vlerësimit të nevojave për trajnim për të ofruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe sa më pranë realitetit të sistemit të drejtësisë;
2. Analizimin dhe përmirësimin e metodologjisë së aktiviteteve trajnuese. Përditësimi dhe pasurimi i programeve do të mbetet prioritet, duke marrë në konsideratë nxitjen që vjen nga jeta shkencore;
3. Zhvillimin e aftësive trajnuese nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit të trajnerëve;
4. Përzgjedhjen e trajnerëve mbi bazë merite dhe në transparencë të plotë, duke i dhënë përparësi rritjes së përfshirjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si edhe ndjekjes me kujdes të procesit për përgatitjen e kurikulave dhe të moduleve të trajnimit prej trajnuesve. Për më tepër, do t'i jepet rëndësi kualifikimit të stafit të ekspertëve trajnues (ose pedagogjik) për seminare të cilat janë krejt të reja për nga tematika, ose të tilla që janë organizuar deri tani nga Shkolla, por pjesërisht janë mbështetur edhe nga ekspertë të ardhur prej partnerëve ndërkombëtarë;
5. Përshtatjen e kalendarit të aktiviteteve trajnuese në rastet e ndryshimeve të rëndësishme në legjislacion me qëllim diskutimin dhe interpretimin e tyre mes profesionistëve të së drejtës;

6. Trajnimin në grupe të caktuara për ofrimin e njohurive dhe përcimin e aftësive të specializuara, si për shembull, trajnimet e këshillave të gjykatës, drejtuesit e prokurorisë, kancelarët, avokatët e shtetit, inspektorët e drejtësisë, këshilltarët/ndihmësit ligjorë, trajnime të dedikuara për gjyqtarë administrativë, trajnime për prokurorët e prokurorisë së posaçme, për anëtarët e Gjykatës së Lartë etj.;
7. Aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, në lidhje me implementimin e rregullave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe parimet për të drejtën e shtetasve për një gjykim të drejtë e të shpejtë, të drejtën e mbrojtjes dhe të barazisë në gjyq, të drejtën për t'u gjykuar nga një gjyqtar i paanshëm. Në këtë pikëpamje, qëllimi ynë do të jetë vazhdimi, si më parë, i trajnimit të gjyqtarëve e prokurorëve në lidhje me çështje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Etikës Profesionale të Gjyqësorit dhe në të njëjtën kohë, zhvillimin e trajnimeve të reja për aksesin në drejtësi dhe për një lidhje më të drejtpërdrejtë të gjyqtarëve dhe prokurorëve me tema të fokusuara mbi çështje të kontekstit social;
8. Trajnimin e magjistratëve shqiptarë mbi ligjin dhe standardet e BE-së dhe praktikën ndërkombëtare;
9. Identifikimin e nevojave për kurse të reja në fusha të tjera paralelisht me kurset ekzistuese për të rritur aftësitë gjyqësore mbi efektet e faktorëve shoqërorë në rritjen e përgjegjësisë sociale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për shembull, në fushën e logjikës, qëndrimit dhe sjelljes, dhe psikologjisë gjyqësore e të tjera.

Së dyti, për shkak të ngarkesës dhe përgjegjësisë së madhe që ka Sektori i Formimit Vazhdues në Shkollë, prioritet i Shkollës do të jetë forcimi i kapaciteteve administrative dhe maksimizimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe platformave në dispozicion, në funksion të mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave, ruajtjes së tyre, shpërndarjes së materialeve dhe komunikimit me subjektet e këtij programi. Objektivat në mbështetje të këtij rezultati janë:

1. përmirësimi i sistemit të mbajtjes së të dhënave lidhur me aspekte të ndryshme të komponentëve të Formimit Vazhdues, të tilla, si: listat e pjesëmarrësve, ditët e trajnimit mbi baza vjetore dhe 5-vjeçare, tematika, certifikimi, aplikimi *on line* etj.;
2. përmirësimi i aspekteve të koordinimit të aktiviteteve trajnuese dhe zyrtarizimit të protokolleve dhe mënyrave të njoftimit të pjesëmarrësve nga ana e Shkollës dhe e konfirmimit të pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes, përmes sistemit të ri të krijuar në Shkollë;
3. zhvillimi i komunikimit me gjyqtarët dhe prokurorët nëpërmjet përdorimit të teknologjisë ekzistuese dhe në zhvillim. Shkolla ka faqen e saj të internetit, në të cilën do të paraqiten informacione të ndryshme. Do të jemi vazhdimisht të përditësuar me ndryshimet në teknologji dhe do të kërkojmë që të përfitojmë plotësisht nga burimet e disponueshme të internetit. Ndër të tjera, kjo do të përfshijë zhvillimin e mëtejshëm të faqes së internetit në përfitim të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, duke zhvilluar dhe stimuluar përdorimin e forumit të diskutimit në internet dhe përhapjen e informacionit ligjor me anë të komunikimit online me ta. Ne do të vazhdojmë t'i kushtojmë vëmendje përmirësimit të faqes së internetit të Shkollës për ta bërë sa më të dobishme që të mundemi, midis të tjerave duke: hedhur informacion në lidhje me kurset e ardhshme, në mënyrë që të rritet pjesëmarrja; me hedhjen e materialeve ligjore, si leksione jurisprudence të mbledhura nga seminarët, në mënyrë që njohuritë e trajnimit të përhapen në të gjithë vendin;
4. përdorimi i sistemit të ri të teknologjisë së informacionit në lidhje me aplikimin apo edhe disponimin e materialeve trajnuese, ku çdo gjyqtar apo prokuror, të ketë mundësinë e pasjes

së të gjitha materialeve trajnuese të përdorura nga ekspertët në aktivitetet përkatëse, por edhe të kontrollojë temat për të cilat ka interes;

5. bashkëpunimi më i ngushtë me Këshillat dhe organe të tjera të larta të drejtësisë në vend me qëllim këshillimin, shkëmbimin e ideve dhe nxitjen e rritjes profesionale përmes trajnimit.

II. I. c Për projektet dhe marrëdhëniet me jashtë

Synohet të zhvillohen mundësitë e partneriteteve dhe shkëmbimeve mes Shkollës, institucioneve të tjera të trajnimit gjyqësor jashtë vendit dhe institucione apo organizma të rëndësishëm ndërkombëtarë, me qëllim mbështetjen e veprimtarisë akademike dhe studimore në Shkollë në disa drejtime.

Në zbatim të rolit të tij mbështetës në realizimin e veprimtarisë akademike dhe profesionale të programeve të formimit profesional të Shkollës, Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë synon të mundësojë zbatimin e drejtimeve të mëposhtme në aktivitetin e tij.

1. Vijimi i përfaqësimit dinjitoz të kandidatëve tanë për magistratë në Konkursin Ndërkombëtar e-THEMIS, ku Shkolla në vijimësi ka fituar pozicione të vlerësuara nga juritë e konkursit.
2. Mundësimi i pjesëmarrjes së pedagogëve, ekspertëve, trajnerëve, gjyqtarëve, prokurorëve në aktivitetet trajnuese të institucioneve të ndryshme të trajnimit gjyqësor të BE-së sipas fushave të interesit.
3. Pjesëmarrje e vazhdueshme e kandidatëve për magistratë në programet e shkëmbimit dhe aktivitetet ndërkombëtare gjyqësore të organizuara nga akademitë e ndryshme gjyqësore në Evropë.
4. Akomodimi dhe harmonizimi i kërkesave për bashkëpunim që vijnë nga donatorë të ndryshëm pa ceduar nga prioritetet e drejtimeve kryesore të proceseve akademike, administrative dhe institucionale të Shkollës, me synimin për të përfituar maksimalisht nga interesi për bashkëpunim i partnerëve ndërkombëtarë.
5. Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve në drejtim të planifikimit strategjik, hartimit dhe zbatimit të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit me donatorët.

II. I. d Publikimet dhe puna kërkimore shkencore 2023-2024

Kërkimi shkencor dhe publikimi mbeten pika kyçe të veprimtarisë dhe prioritetëve të Shkollës. Synohet që aktivitetet dhe produktet që do të realizohen në Departamentin e Studimeve dhe Publikimeve të jenë të shumta dhe të larmishme. Ato do të kenë vizibilitet më të lartë dhe më shumë përdorues.

Gjatë periudhës 2023-2024, ky program do të fokusohet në:

14. Botimin nën emrin dhe kujdesin e Shkollës së Magistraturës të teksteve dhe librave të cilët trajtojnë probleme ligjore të lidhura ngushtë me programet e lëndëve dhe kurseve të

- formimit fillestar e vazhdues të gjyqtarëve e prokurorëve, duke synuar në unifikimin dhe analizimin e praktikës gjyqësore e juridike kombëtare dhe ndërkombëtare;
15. Botimin e titujve me praktikë gjyqësore (Case study) dhe publikime të tjera shkencore në funksion të studiuesve të së drejtës;
 16. Përgatitjen e manualeve, moduleve/cikleve të leksioneve për lëndë apo tema që trajtohen në procesin e formimit fillestar të magjistratëve, nga grupe autorësh;
 17. Botimin, në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, të përmbledhjeve të transkriptimeve të përmbajtjes së trajnimeve të zhvilluara në programin e formimit vazhdues;
 18. Publikimin e revistave shkencore dhe publikime të tjera sipas Rregullores në mënyrë periodike;
 19. Ngritjen e grupeve të studimit dhe kërkimit në fusha prioritare të së drejtës, të përzgjedhur nëpërmjet një metodologjie të hartuar për këtë qëllim si dhe ofrimin e trajnimit për kërkuesit e rinj që i bashkohen grupeve të studimit/kërkimit;
 20. Krijimin e një grupi pune të përhershëm që realizon punë paraprake kërkimore dhe analizuese në funksion të studimit të grupeve të ngritura, i cili do parashikojë kohën se kur mund të publikohen produktet e përfutuara, mundësitë dhe mjetet për rritjen e vizibilitetit të produkteve;
 21. Përdorimin e metodave teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve që lehtësojnë dhe nxisin bashkëpunimin mes Shkollës dhe subjekteve të saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në vend dhe ndërkombëtarë, duke siguruar ndërveprim të gjerë dhe vizibilitet të lartë të Shkollës;
 22. Përdorimin e moduleve të shumta e-learning të prodhuara në Evropë ose të krijuara në Shkollë;
 23. Shkëmbimin e burimeve (dokumente, botime shkencore, kurikula trajnimi dhe çdo “mjet trajnimi” tjetër i cili do të mund të kontribuojë në përmirësimin e njohurive dhe dijeve të sistemeve gjyqësore dhe juridike përkatëse) me shkolla homologe dhe partnerët kombëtarë/ndërkombëtarë;
 24. Zhvillimin e kapaciteteve të saj për të dorëzuar dhe menaxhuar projekte që lidhen me trajnimin gjyqësor, veçanërisht në kuadër të Programit të BE-së për Drejtësi dhe në partneritet me EJTN-në dhe anëtarët e saj;
 25. Pasurimin në mënyrë të vazhdueshme të bibliotekës digjitale;
 26. Zhvillimin dhe përmirësimin e platformave dhe Forumit të Shkollës së Magjistraturës.

II.I. e Për avancimin e Teknologjisë së Informacionit

Në zbatim të VKM-në datë 2.12.2020, “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë”, organ që do të veprojë pranë KLGJ-së, Shkolla e Magjistraturës ka një rol aktiv në vendimmarrjen e Qendrës si pjesë e Bordit Drejtues të saj.

Në bashkëpunim me këtë qendër për miratimin e dokumentacionit për standardizimin e teknologjisë së informacionit, SHM do të krijoj një sistem të ri digjital, modern dhe funksional të menaxhimit të veprimtarisë akademike (SMVSHM), e cila do të kapërcejë vështirësitë operacionale dhe do të jetë një hap tjetër drejt transformimit digjital të shërbimeve.

Sistemi do të ofrojë automatizim të lartë dhe do të mbështesë rrjedhën e punës brenda institucionit, duke synuar rritjen e efikasitetit të punës, aksesit të aplikantëve për t'u regjistruar në SHM, si dhe të kandidatëve që ndjekin Programin e Formimit Fillestar, stafit pedagogjik dhe administrativ, gjyqtarëve, prokurorëve, ndihmësve ligjorë, kancelarëve, këshilltarëve, avokatëve të shtetit etj, në programet e SHM-së, transparencës, raportimit statistikor si dhe llogaridhënies. Gjithashtu, sistemi do të ndihmojë edhe për komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë, të tillë si Këshilli i Lartë i Gjyqësorit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Prioritet do të jetë edhe sigurimi i të gjitha pajisjeve hardware që do të nevojiten për SMVSHM dhe qendëzimin e infrastrukturës së serverëve, si dhe kërkesat e sigurisë së sistemit si program kompjuterik (software).

Në sektorin e Teknologjisë së Informacionit synohet të përmirësohet infrastruktura nëpërmjet sigurimit të një numri të përshtatshëm pajisjesh teknologjike, si për shembull tabela të reja elektronike interaktive, që do t'i shërbejnë të gjitha sallave të Programit të Formimit Fillestar dhe risistemimit të sistemit të audios dhe videos në të gjitha sallat, për të siguruar regjistrimin pa ndërprerje të videos dhe audios në të njëjtën kohë, në funksion të transparencës së mbledhjeve të organeve drejtuese të SHM-së apo regjistrimit të sesioneve trajnuese si dhe monitorimit të vazhdueshëm të procesit të provimeve gjate vitit akademik.

Një prioritet i rëndësishëm për Shkollën do të vijojë të jetë rritja e vizibilitetit, jo vetëm për të pasqyruar aktivitetet e Shkollës në funksion të parimit të transparencës dhe informimit, por edhe për të rritur interesin dhe për të forcuar besimin e publikut për Shkollën e Magjistraturës.